

INTOSAI



Kodi i Etikës

dhe

Standardet e Auditimit

Komisioni për Standarde të Auditimit

Inga-Britt Ahlenius, Auditore e Përgjithshme
Riksrevisionsverket
(Swedish National Audit Office)
P.O. Box 45070
S-104 30 Stockholm
Sweden

Tel: ++46 (8) 690 - 4000
Fax: ++46 (8) 690 - 4123
E-mail: int@rrv.se

INTOSAI



INTOSAI General Secretariat - RECHNUNGSHOF
(Austrian Court of Audit)
DAMPFSCHIFFSTRASSE 2
A-1033 VIENNA
AUSTRIA
Tel.: ++43 (1) 711 71 • Fax: ++43 (1) 718 09 69

E-MAIL: intosai@rechnungshof.gv.at;
WORLD WIDE WEB: <http://www.intosai.org>

Parathënie

Në INCOSAI-n (shqip KNILA – Kongresi Ndërkombëtar i Institucioneve të Larta të Auditimit) e XVI-të në Montevideo në vitin 1998, Kongresi unanimitisht kishte aprovuar dhe nxjerr Kodin e Etikës së INTOSAI-t.

Në po të njëjtin takim, për më tepër, ishte vendosur që Komisioni i INTOSAI-t për Standarde të Auditimit duhej t'i ristrukturonte Standardet e Auditimit në mënyrë që të lehtësonte përditësimet dhe shtimet e mundshme në të ardhmen, por pa ndryshuar përmbajtjen e tyre.

Komisioni tani ka përpiluar një version të ristrukturuar të Standardeve të Auditimit.

Për arsye praktike, është propozuar që Kodi i Etikës dhe Standardet e Auditimit të jenë në dispozicion në një vëllim të përbashkët.

Është megjithatë e rëndësishme për të parë lidhjen në mes të dokumenteve relevante të INTOSAI-t:

Sipas Deklaratës së Limas mbi Direktivat e Normave të Auditimit, që nga themelimi i tij, Kodi i Etikës i INTOSAI-t duhet të shihet si një plotësues i domosdoshëm, që fuqizon Standardet e Auditimit të INTOSAI-t të lëshuara nga Komisioni për Standarde të Auditimit i INTOSAI-t në qershor të vitit 1992.

Në procesverbalin e takimit të XVI-të të KNILA-s të mbajtur në vitin 1998 është cekur me sa vijon.

Dokumentet e ndryshme mund të konsiderohen si kornizë gjithëpërfshirëse me elementet vijuese:

- Deklarata e Limas është baza së bashku me normat e saj gjithëpërfshirëse të auditimit të sektorit publik.
 - Kodi i Etikës përfaqëson nivelin tjetër me deklaratën e saj mbi vlerat dhe parimet që udhëheqin punën ditore të auditorëve. Njëra nga parimet e cekura në Kodin e Etikës është obligimi i auditorit të aplikoj standardet audituese të pranuarra gjerësisht.
-

- Standardet e Auditimit në nivelin vijues, përmbajnë postulatet dhe parimet për kryerjen e punës audituese.
- Materiali Udhërrëfyes, që përbëjnë nivelin e katërt, ofron asistencë praktike për ILA-n (Institucionin e Lartë të Auditimit) në implementimin e standardeve në substance e tyre.

Në këtë vëllim, rrjedhimisht, do të gjendet edhe Kodi i Etikës së bashku me Standardet e Ristrukturuar të Auditimit, vëllim ky i miratuar nga Kongresi i XVII-të i INTOSAI-të në Seul në vitin 2001.

*Inga-Britt Ahlenius
Kryetare e Komisionit për Standarde të Auditimit*



Përmbajtja

Kodi i Etikës.....	3
Standardet e Auditimit.....	17



Kodi i Etikës

I lëshuar nga Komisioni për Standarde të Auditimit në Kongresin e XVI-të të INTOSAI-t të mbajtur në vitin 1998 në Montevideo, Uruguai



Përmbajtja

Parathënie.....	7
Hyrje.....	8
Kreu 1.....	10
<i>Hyrje.....</i>	<i>10</i>
Kreu 2.....	12
<i>Integriteti.....</i>	<i>12</i>
Kreu 3.....	13
<i>Pavarësia, Objektiviteti dhe Paanshmëria.....</i>	<i>13</i>
Kreu 4.....	15
<i>Fshehtësia Profesionale.....</i>	<i>15</i>
Kreu 5.....	15
<i>Kompetenca/Aftësia.....</i>	<i>15</i>
Lista e Fjalëve.....	16



Parathënie

Kam kënaqësinë të i paraqes anëtarëve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI, shqip ONILA,) Kodin e Etikës për auditorët në sektorin publik, i cili ka marr miratimin e Bordit Qeverisës në takimin e 44-të në Montevideo në nëntor 1998.

Kodi përbën një hap të rëndësishëm përpara në procesin e harmonizimit të koncepteve etike brenda INTOSAI-t. Ai përbëhet vetëm nga postulatet bazë të etikës, pasi që dallimet nacionale të kulturës, gjuhës dhe sistemeve ligjore dhe sociale sjellin nevojën për t'ia përshtatur postulatet e tilla rrethanave të vendit të caktuar. Rrjedhimisht, ky Kod duhet të shihet si bazë për kodet kombëtare të etikës që secili Institucion i Lartë i Auditimit duhet të nxjerr.

Në fund, në emër të Komisionit për Standarde të Auditimit, do të dëshiroja të shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin tim më të thellë për bashkëpunimin e të gjithë anëtarëve të INTOSAI-t në përpjekjen tonë të përbashkët për të nxjerr këtë Kod të Etikës. Unë po ashtu do falënderoja kolegët e Komisionin për mbështetjen e tyre në kohë dhe kontributin pozitiv në tërë këtë aktivitet.

Inga-Britt Ahlenius

Kryetare e Komisionit për Standarde të Auditimit

Hyrje

Ky draft Kod i Etikës është rezultat i punës së përbashkët së anëtarëve të Komisionit për Standarde të Auditimit i INTOSAI-t, i cili përfshinte Institucionet e Larta të Auditimit nga:

*Austria
Australia
Argjentina
Brazili
Kosta Rika
Japonia
Filipinet
Portugalia
Arabia Saudite
Suedia; Kryetarja
Mbretëria e Bashkuar
Shtetet e Bashkuara*

Një plan pune për Komisionin ishte prezantuar dhe miratuar nga Bordi Qeverisës gjatë takimit të 42-të të mbajtur në Vjenë më 24 qershor 1996. Krijimi i këtij Kodi të Etikës ishte një nga detyrat e parapara në atë plan. Aktiviteti për të përmbushur këtë detyrë kishte filluar me mbledhjen e Kodeve të Etikës nga të gjithë anëtarët e INTOSAI-t me qëllim që të studiohen ngjashmëritë dhe dallimet. Kjo çoj në draftin e parë preliminar të diskutuar gjatë takimit të Komisionit në Suedi në janar 1997.

Pas takimit të Komisionit, ishte përpiluar një draft i ri dhe ai i ishte dërguar të gjithë anëtarëve të INTOSAI-t për komente. Pasi që këto komente ishin marrë parasysh, ishte nxjerr ky draft final.

Bordi Qeverisës ishte informuar në lidhje me progresin e punës gjatë takimit të 43-të në Montevideo në nëntor 1997.

Do të dëshiroja të falënderoja të gjithë anëtarët e Komisionit të INTOSAI-t për Standarde të Auditimit për përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre, në realizimin e këtij projekti.

Inga-Britt Ahlenius

*Auditore e Përgjithshme, Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit
Kryetare, Komisioni i INTOSAI-t për Standarde të Auditimit*

Kreu 1

Hyrje

Nocioni, Historiku dhe Qëllimi i Kodit të Etikës

1. INTOSAI e ka parë si esenciale për të krijuar një Kod Ndërkombëtar të Etikës për auditorët e sektorit publik.
2. Kodi i Etikës është një formulim gjithëpërfshirës i vlerave dhe parimeve që duhet të drejtojnë punën ditore të auditorëve. Pavarësia, kompetencat dhe përgjegjësitë e auditorit të sektorit publik vendosin kërkesa të larta etike për ILA-të (Institucionet e Larta të Auditimit) dhe për stafin që ato punësojnë apo angazhojnë në punë audituese. Një kod i etikës për auditorët e sektorit publik duhet të merr parasysh kërkesat etike të shërbyesve civil në përgjithësi dhe kërkesat e veçanta të auditorëve, përfshirë obligimet më të fundit profesionale.
3. Sipas Deklaratës së Limas mbi Rregullat e Normave të Auditimit, që nga themelimi i vet, Kodi i Etikës i INTOSAI-t duhet të shihet si një plotësues i domosdoshëm, që fuqizon Standardet e Auditimit të INTOSAI-t të lëshuara nga Komisioni për Standarde të Auditimit i INTOSAI-t në qershor të vitit 1992.
4. Kodi i Etikës i INTOSAI-t i referohet auditorit individualisht, drejtuesit të ILA-së, zyrtarëve ekzekutiv dhe të gjithë individëve që punojnë për ose në emër të ILA-së, të cilët janë të përfshirë në punë audituese. Megjithatë, Kodi nuk duhet të interpretohet si të ketë ndonjë ndikim në strukturën organizative të ILA-së.

Për shkak të dallimeve kombëtare në kulturë, gjuhë dhe sisteme ligjore dhe sociale, është përgjegjësi e secilës ILA të nxjerr Kodin e saj të Etikës, i cili më së miri i përshtatet rrethanave. Do preferohej që këto Kode Etike kombëtare të sqarojnë konceptet/nocionet etike. Kodi i Etikës i INTOSAI-t ka për synim të krijoj bazën për Kodet Etike kombëtare. Është përgjegjësi e çdo Institucioni të Lartë të Auditimit të siguroj që të gjithë auditorët e

1 Nga Kongresi i IX-të i INTOSAI-t, i takuar në Lima. Mund të sigurohet nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t në Austri.

e saj të familjarizohen me vlerat dhe parimet që përmban Kodi Kombëtar i Etikës dhe të veprojnë në përputhje me to.

5. Sjellja e auditorëve duhet të jetë pa asnjë vërejtje gjatë gjithë kohës dhe në çfarëdo rrethanash. Çfarëdo pamjaftueshmërie në sjelljen e tyre profesionale ose çfarëdo sjellje pahijshme në jetën e tyre personale, e vendos integritetin e auditorëve, ILA-në që ata përfaqësojnë, dhe kualitetin dhe vlefshmërinë e punës së tyre audituese në pozitë të palakmueshme dhe mund të bëjnë që të ngrihen dyshime në lidhje me besueshmërinë dhe aftësinë e vet ILA-së. Miratimi dhe aplikimi i kodit të etikës për auditorët në sektorin publik, promovon mirëbesim dhe konfidencë në auditorët dhe punën e tyre.

6. Është e rëndësishme fundamentale që ILA të shihet me besim, konfidencë dhe kredibilitet. Auditori promovon këtë duke miratuar dhe aplikuar kërkesat etike të nocioneve të mishëruara në fjalët kryesore Integritet, Pavarësi dhe Objektivitet, Konfidencë dhe Aftësi.

Besimi, Konfidenca dhe Kredibiliteti

7. Autoriteti legjislativ dhe/ose ai ekzekutiv, publiku i gjerë dhe entitetet e audituara kanë të drejtë të presin që qasja dhe sjellja e ILA-së të jetë përtej çdo dyshimi dhe vërejtjeje dhe të jetë meritore e respektit dhe besimit.

8. Auditorët duhet të sillen në atë mënyrë që të promovojnë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira në mes të auditorëve në kuadër të profesionit.

Mbështetja e profesionit nga anëtarët e tij dhe bashkëpunimi i tyre me njëri tjetrin janë elemente esenciale të karakterit profesional. Besimi dhe respekti i publikut që gëzon auditori është në pjesën më të madhe si rezultat i arritjeve të përbashkëta të të gjithë auditorëve, nga e shkuara dhe e tanishmja. Rrjedhimisht, është në interes të auditorëve si dhe në interes të publikut të gjerë që auditori të merret me kolegët auditorë në mënyrë të drejtë dhe të ekuilibruar.

9. Autoriteti legjislativ dhe/ose ai ekzekutiv, publiku i gjerë dhe entitetet e audituara duhet të jenë plotësisht të siguruara për drejtësinë dhe paanshmërinë e të gjithë punës së ILA-së. Për këtë, është esenciale që të ekzistoj një Kod kombëtar i Etikës ose dokument i ngjashëm që rregullon dispozitat e shërbimeve.

10. Në të gjitha poret e shoqërisë ekziston nevoja për kredibilitet. Prandaj, është esenciale që raportet dhe opinionet e ILA-së të pranohen se jenë tërësisht të sakta dhe të besueshme nga palët e treta mirë të informuara.

11. E tërë puna e kryer nga ILA duhet të kalojë testin ekzaminues legjislativ dhe/ose të ekzekutiv, testin e opinionit publik për sa i takon korrektësisë dhe ekzaminimit në raport me Kodit Kombëtar të Etikës.

Kreu 2

Integriteti

12. Integriteti është vlera thelbësore e Kodit të Etikës. Auditorët kanë për detyrë t'iu përmbahen standardeve të larta të mirësjelljes (p.sh. sinqeritetit dhe çiltërsisë) gjatë punës së tyre dhe në marrëdhëniet me stafin e entiteteve që auditohen. Me qëllim që të përfitoj besimin e publikut, sjellja e auditorëve duhet të jetë larg çfarëdo dyshimi apo vërejtjeje.

13. Integriteti mund të matet në lidhje me atë se çfarë është e duhur dhe e drejtë. Integriteti kërkon nga auditorët që të respektojnë si formën ashtu edhe frymën e standardeve etike dhe të auditimit. Integriteti po ashtu kërkon nga auditorët që të respektojnë parimet e pavarësisë dhe objektivitetit, të mbajnë standardet e paqortueshme të sjelljes profesionale, të marrin vendime duke pasur në mendje interesin e publikut dhe të aplikojnë sinqeritet absolut gjatë kryerjes së punës së tyre dhe gjatë administrimit të resurseve të ILA-së.

Kreu 3

Pavarësia, Objektiviteti dhe Paanësia

14. Pavarësia nga entitetet e audituara dhe grupet e tjera të jashtme të interesit është e detyrueshme për auditorët. Kjo nënkupton që auditorët duhet të sillen në atë mënyrë që të rrisin apo që në asnjë mënyrë të mos zvogëlojnë, pavarësinë e tyre.

15. Auditorët duhet të përpiqen jo vetëm të jenë të pavarur nga entitetet e audituara dhe grupet e tjera të interesit por po ashtu të jenë objektiv gjatë ballafaqimit me çështjet dhe temat që janë subjekte të rishikimit.

16. Është esenciale që auditorët të jenë të pavarur dhe të paanshëm, jo vetëm gjatë veprimit por edhe në dukje.

17. Në të gjitha çështjet që ndërlidhen me punën audituese, pavarësia e auditorëve nuk duhet të dëmtohet nga interesa personale ose të jashtme.

Pavarësia mund të dëmtohet, për shembull, përmes presionit ose ndikimit të jashtëm tek auditorët; paragjykimet e mbajtura nga auditorët në lidhje me individët e caktuar, entitetet e audituara, projektet apo programet; ish të punësuarit e kohës së fundit me entitetin e audituar; ose marrëveshjet personale ose financiare të cilat të shkaktojnë konflikte të besnikërisë apo të interesit. Auditorët e kanë për obligim të përmbahen nga përfshirja në të gjitha çështjet ku ata kanë një interes profesional.

18. Ekziston nevoja për objektivitet dhe paanësi në të gjitha punët e kryera nga auditorët, veçanërisht në lidhje me raportet e tyre, të cilat duhet të jenë të sakta dhe objektive. Konstatimet në opinionet e lëshuara dhe në raporte, rrjedhimisht duhet të bazohen ekskluzivisht në dëshmitë e siguruara, të mbledhura në harmoni me standardet e auditimit të ILA-së.

19. Auditorët duhet t'i shfrytëzojnë të dhënat e siguruara nga entitetet e audituara dhe palët tjera. Këto të dhëna, në mënyrë të paanshme duhet të merren parasysh gjatë dhënies së opinioneve nga ana e auditorëve. Auditori duhet po ashtu të mbledhë të dhëna në lidhje me pikëpamjet e entitetit të audituar dhe palëve të tjera. Megjithatë, konkluzionet e vet auditorëve nuk duhet të ndikohen nga pikëpamjet e tilla.

Paanësia politike

20. Është e rëndësishme të mbahet si neutraliteti politik ekzistues ashtu dhe neutraliteti politik i shfaqur nga ILA. Prandaj, është me rëndësi që auditorët të ruajnë pavarësinë e tyre ndaj ndikimit politik, me qëllim që t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre audituese në mënyrë të paanshme. Kjo është e rëndësishme për auditorët pasi që ILA-të bashkëpunojnë nga afër me autoritetet ligjore, ekzekutive ose me ndonjë entitet tjetër qeveritar i autorizuar nga ligji për të marrë parasysh raportet e ILA-së.

21. Është e rëndësishme që atëherë kur auditorët ndërmarrin, ose kanë ndër mend të ndërmarrin aktivitete politike, ata duhet të kenë parasysh ndikimin që një përfshirje e tillë mund të ketë – ose duket të ketë - në aftësinë e tyre për të kryer detyrat e tyre profesionale në mënyrë të paanshme. Nëse auditorët lejohen të marrin pjesë në aktivitete politike, ata duhet të jenë të vetëdijshëm se këto aktivitete mund të shpijnë në konflikte profesionale.

Konfliktet e interesit

22. Atëherë kur auditorët lejohen për të ofruar këshillë-dhënie/informata apo shërbime tjera nga ato të auditimit, për entitetin e audituar, duhet të bëhet kujdes që këto shërbime të mos shpijnë në konflikt interesash. Në veçanti, auditorët duhet të garantojnë që këshilla apo shërbime të tilla nuk përfshijnë përgjegjësitë apo kompetencat e menaxhmentit, të cilat duhet me vendosmëri duhet të mbesin te menaxhmenti i entitetit të audituar.

23. Auditorët duhet të mbrojnë pavarësinë e tyre dhe të shmangin çfarëdo konflikti të mundshëm të interesave duke refuzuar dhuratat ose shpërblimet të cilat mund të influencojnë apo të duken se influencojnë pavarësinë dhe integritetin e tyre.

24. Auditorët duhet të shmangin të gjitha marrëdhëniet me menaxherët dhe stafin e entiteteve të audituara dhe me palët tjera të cilat mund të influencojnë, komprometojnë ose kanosin aftësinë e auditorëve që të veprojnë dhe të duken që po veprojnë në mënyrë të pavarur.

25. Auditorët nuk duhet të përdorin pozitën e tyre zyrtare për qëllime private dhe duhet të shmangin marrëdhënien ku përfshihet rreziku për korrupsion ose e cila mund të ngre dyshime në lidhje me objektivitetin dhe pavarësinë e tyre.

26. Auditorët nuk duhet të përdorin informacionin e mbledhur gjatë kryerjes së detyrave të tyre si formë për të siguruar përfitime personale për veten e tyre apo për të tjerët. Ata po ashtu nuk duhet të zbulojnë informata që do t'i jepnin një avantazh të padrejtë ose të paarsyeshëm individëve apo organizatave të tjera dhe as nuk duhet të përdorin informata të tilla si mjet për të dëmtuar të tjerët.

Kreu 4

Sekreti Profesional

27. Auditorët nuk duhet të shpalosin për palët e treta, informata të siguruar gjatë procesit të auditimit, qofshin ato në formë të shkruar apo gojore, përveç për qëllime që përmbushin përgjegjësitë statutorë të ILA-s apo përgjegjësi tjera të njohura si pjesë të procedurave normale të ILA-së, ose në përputhje me ligjet përkatëse.

Kreu 5

Aftësia

28. Auditorët kanë për detyrë të sillen në mënyrë profesionale gjatë gjithë kohës dhe të aplikojnë standardet e larta profesionale gjatë kryerjes së punës së tyre, për t'i mundësuar ata të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë kompetente dhe duke mos anuar nga njëri apo krahu tjetër.

29. Auditorët nuk duhet të ndërmarrin punë të cilën ata nuk janë të aftë ta kryejnë.

30. Auditorët duhet të dinë dhe ndjekin auditimin aplikativ, kontabilitetin dhe standardet e menaxhimit financiar, politikat, procedurat dhe praktikat.

Gjithashtu, ata duhet të posedojnë njohuri të duhura mbi parimet dhe standardet kushtetuese, ligjore dhe institucionale që qeverisin funksionimin e entitetit të audituar.

Zhvillimi Profesional

31. Auditorët duhet të ushtrojnë kujdes të duhur profesional gjatë kryerjes dhe mbikëqyrjes së auditimit dhe gjatë përgatitjes së raporteve përkatëse.

32. Auditorët duhet të përdorin metodat dhe praktikat e kualitetit më të lartë të mundshëm gjatë auditimeve të tyre. Në kryerjen e auditimit dhe nxjerrjen e raporteve, auditorët kanë për obligim që t'iu përmbahen postulateve bazë dhe standardeve audituese gjerësisht të pranuar.

33. Auditorët kanë një obligim të vazhdueshëm që të përditësojnë dhe përmirësojnë shkathësitë e nevojshme për ekzekutimin e përgjegjësive të tyre profesionale.

Lista e Fjalëve

Fjalët e përdorura në këtë Kod të Etikës kanë të njëjtin interpretim apo definicion me ato të përdorura në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t.

Standardet e Auditimit

Lëshuar nga Komisioni për Standarde të Auditimit në Kongresin e XIV-të të INTOSAI-t të mbajtur në vitin 1992 në Uashington, D.C., Shtetet e Bashkuara, të amenduara gjatë Kongresit të XV-të të INTOSAI-t i mbajtur në Kajro të Egjiptit në vitin 1995.

Përmbajtja

Parathënie.....	21
Hyrje.....	22
Kreu I.....	25
<i>Parimet Bazë të Auditimit Qeveritar.....</i>	<i>25</i>
Kreu II.....	35
2.1 <i>Standardet e Përgjithshme të Auditimit Qeveritar.....</i>	<i>35</i>
2.2 <i>Standardet me Domethënie Etike.....</i>	<i>41</i>
Kreu III.....	49
<i>Standardet e Terrenit gjatë Auditimit Qeveritar.....</i>	<i>49</i>
3.1 <i>Planifikimi.....</i>	<i>51</i>
3.2 <i>Mbikëqyrja dhe Rishikimi.....</i>	<i>53</i>
3.3 <i>Studimi dhe Vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm.....</i>	<i>54</i>
3.4 <i>Respektimi i Ligjeve dhe Rregulloreve.....</i>	<i>55</i>
3.5 <i>Dëshmia e Auditimit.....</i>	<i>57</i>
3.6 <i>Analizimi i Pasqyrave Financiare.....</i>	<i>58</i>
Kreu IV.....	60
<i>Standardet e Raportimit në Auditimin Qeveritar.....</i>	<i>60</i>
Lista e Fjalëve.....	68



20

Parathënie

Ky rishikim i Standardeve të Auditimit të INTOSAI-t është një hap i rëndësishëm përpara në zhvillimin e standardeve të vërteta ndërkombëtare të auditimit. Ishte rekomandim i dal gjate KNILA-së së XIII—të (Berlin) që versioni i mëparshëm të amendohet për të reflektuar nevojat e veçanta të vendeve, ILA-të e të cilave janë të strukturuar si gjykata të llogarive.

Flas në emër të Komisionit për Standarde të Auditimit kur shpreh vlerësimin për përpjekjet e bëra nga të gjithë anëtarët e INTOSAI-t, për nxjerrjen e standardeve. Në veçanti do të dëshiroja të falënderoja kontributet tepër të çmuara të Gjykatës së Llogarive të Belgjikës, anëtarit më të ri të Komisionit të INTOSAI-t për Standarde të Auditimit dhe të ILA-ve të tjera që janë të strukturuar si gjykata të llogarive. Unë po ashtu do të dëshiroja të falënderoja kolegët e mi të tjerë të Komisionit për përkrahjen e tyre dhe kontributin pozitiv të dhënë për këtë rishikim.

Përderisa Standardet e Auditimit të INTOSAI-t nuk kanë një aplikim të obligueshëm, ato prapë reflektojnë konsensusin mbi “praktikat më të mira” në mesin e ILA-ve. Çdo ILA duhet të vlerësoj dhe gjykoj shkallën deri ku standardet përkojnë me arritjen e mandatit të tyre.

Është mendim si i Bordit Qeverisës ashtu dhe i Komisionit për Standarde të Auditimit, që këto standarde janë një dokument “i gjallë”. Si të tilla ato duhet të pasqyrojnë, deri aty ku munden, tendencat aktuale, çështjet dhe shqetësimet në metodologjinë dhe praktikatat e auditimit.

Bordi Qeverisës ka dhënë aprovimin e tij për këto Standarde gjatë takimit të 35-të në Uashington në tetor të vitit 1991. Unë ua dorëzoi anëtarëve të INTOSAI-t standardet e rishikuara.

J.C. Taylor

Kryetar i Komisionit për Standarde të Auditimit

Hyrje

Si kryetar i Komisionit të INTOSAI-t për Standarde të Auditimit, kam kënaqësinë të ju paraqes draftin final të punës sonë.

Komisioni ynë ishte themeluar në maj të vitit 1984 për të nxjerr rekomandimet dhe planet për zhvillimin e një projekti të INTOSAI-t për standarde të auditimit. Rrjedhimisht, Komisioni ishte zgjeruar për të përfshirë Institucionet e Larta të Auditimit të:

- Austrisë: ex-Officio
- Argjentinës
- Australisë
- Brazilit
- Kosta Rikës
- Japonisë
- Filipineve
- Arabisë Saudite: Kryetari
- Suedisë
- Mbretërisë së Bashkuar
- Shteteve të Bashkuara

Një plan pune i ishte prezantuar Komisionit dhe ishte miratuar nga Bordi Qeverisës gjatë takimit të tij, të mbajtur në Sidnej në mars të 1985-ës. Ky plan pune bënte thirrje për formimin e katër grupeve studiuëse për të ndarë punën me sa vijon:

- Grupi i parë i përbërë prej Shteteve të Bashkuara (Koordinator Grupi) Kosta Rikës dhe Filipineve, të punonin në "Parimet e Përgjithshme të Auditimit Qeveritar".
- Grupi i dytë i përbërë prej Australisë (Koordinator i Grupi) dhe Argjentinës, të punonin në "Standardet e Përgjithshme të Auditimit Qeveritar".
- Grupi i tretë i përbërë prej Suedisë (Koordinator Grupi) dhe Japonisë, të punonin në "Standardet e Terrenit në Auditimin Qeveritar".
- Grupi i katërt i përbërë prej Mbretërisë së Bashkuar (Koordinator Grupi) Dhe Brazilit, të punonin në "Standardet e raportimit në Auditimin Qeveritar".

Secili nga katër grupet kishin përgatitur një memorandum të diskutimit në lidhje me subjektin e tyre dhe kishin nxjerr, analizuar dhe studiuar komentet dhe sugjerimet nga anëtarët e tjerë të komisionit. Mbi bazë të këtij memorandum diskutimesh, sugjerimet dhe komentet ishin përfshirë në draftet fillestare të nxjerra për secilin subjekt. Studime, sugjerime dhe komente shtesë të pranuar nga Bordi Qeverisës i INTOSAI-t dhe anëtarët e komisionit, kishin rezultuar me përgatitjen e drafteve finale për ekspozim. Bordi Qeverisës kishte miratuar këto drafte në maj të vitit 1987, gjatë takimit të mbajtur në Vjenë dhe e kishte mandatar Komisionin të takojë në Londër për të harmonizuar terminologjinë dhe stilin e që të katër drafteve.

Një grup ekspertësh që përfaqësonte Komisionin, ishte takuar për pesë ditë në Londër gjatë qershorit të vitit 1987, për të përgatitur draftin final të konsoliduar. Ky grup ekspertësh përbëhej nga Z. Abdullah I. Al Saleh dhe Dr. Issam J. Meri nga Arabia Saudite (Kryetar), Z. W.A. Broadus (Shtetet e Bashkuara), Z. Nazario Anis (Filipine), Z. Cyril Monaghan (Australi), Znj. Gunhild Lindstrom (Suedi), Z. Fernando Goncalves (Brazil) dhe zotërinjtë John Pearce dhe Andy Burchell (Mbretëria e Bashkuar).

Bordi Qeverisës në takimin e tij të 31-të në Berlin ishte pajtuar për aranzhimet vijuese në lidhje me ri-nxjerrjen e Standardeve Audituese të INTOSAI-t dhe marrjen parasysht të çfarëdo komenteve që ishin pranuar:

1. Komentet e pranuar duhet të përpilohen dhe përcillen te Kryetari i Komisionit, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm
2. Kryetari i Komisionit të INTOSAI-t për Standarde të Auditimit dhe Sekretari i Përgjithshëm, duhet të vendosin së bashku në lidhje me domosdoshmërinë dhe nevojën e ndryshimeve të mundshme.
3. Dokumenti, duhet që pastaj t'i dorëzohet Kongresit në Berlin për miratim.

Kryetari i Komisionit dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë analizuar komentet e pranuar dhe kanë bërë ndryshimet siç është parë e nevojshme.

Edhe pse fjala "Standarde" është përdorur gjatë tërë këtij dokumenti, është kuptuar se kjo fjalë do të përdoret në mënyre sinonime me fjalën "direktiva" e cila e mban autoritetin e përputhshmërisë (zbatimit) brenda fushës së secilit Institucion të Lartë të Auditimit.

Do të dëshiroja të falënderoja të gjithë anëtarët e Komisionit të INTOSAI-t për Standarde të Auditimit për përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre, në kompletimin e këtij projekti. Falënderime të veçanta shkojnë për grupin e ekspertëve të cilët kanë përmirësuar draftet finale, gjatë takimit të tyre në Londër.

Omar A. Fakieh, Ministër Shtetëror
President, Byroja e Përgjithshme e Auditimit e Arabisë Saudite
Kryetar, Komisioni i INTOSAI-t për Standarde të Auditimit
Riad, mars 1989

Kreu I

Parimet Bazë në Auditimin Qeveritar

1.0.1 Korniza e përgjithshme e standardeve të auditimit për Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI, shqip ONILA), është nxjerr nga Deklaratat e Limas dhe Tokios, formulimet dhe raportet e miratuara nga INTOSAI në kongrese të ndryshme dhe raporti nga Takimi i Grupit të Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara në lidhje me Kontabilitetin dhe Auditimin Publik në Shtetet në Zhvillim.

1.0.2 Standardet e auditimit të INTOSAI-t përbëhen nga katër pjesë (shiko grafikun):

- (a) Parimet bazë
- (b) Standardet e përgjithshme
- (c) Standardet e terrenit
- (d) Standardet e raportimit

INTOSAI ka nxjerr këto standarde për të siguruar një kornizë për themelimin e procedurave dhe praktikave që duhet ndjekur gjatë kryerjes së një auditimit, përfshirë edhe auditimet e sistemeve me bazë kompjuterike. Ato duhet parë veçanërisht nën rrethana kushtetuese, ligjore etj., të Institucionit të Lartë të Auditimit (ILA).

1.0.3 Parimet bazë për standardet e auditimit janë supozime thelbësore, premisa të qëndrueshme, parime dhe kërkesa logjike, të cilat ndihmojnë në nxjerrjen e standardeve të auditimit dhe iu shërbejnë auditorëve në formimin e opinionëve dhe raporteve të tyre, veçanërisht në ato raste ku nuk aplikohen standardet përkatëse.

1.0.4 Standardet e Auditimit duhet të jenë konsistente me parimet e auditimit. Ato po ashtu sigurojnë orientim minimal për auditorin dhe ndihmojnë në përcaktimin e madhësisë së hapave dhe procedurave të auditimit që duhet ndërmarrë gjatë auditimit. Standardet e Auditimit krijojnë kriterin apo indeksin në raport me të cilin vlerësohen kualiteti dhe rezultatet e auditimit.

1.0.5 Interpretimet dhe shpjegimet e këtyre standardeve janë e drejtë e Bordit Qeverisës së INTOSAI-t, ndërsa amendimet janë përgjegjësi e Kongresit të INTOSAI-t.

1.0.6 Parimet bazë janë

- (a) ILA duhet të merr parasysh respektimin e standardeve të auditimit të INTOSAI-t për të gjitha çështjet që konsiderohen materiale. Standarde të caktuara mund të mos jenë të aplikueshme për disa nga punët e kryera nga ILA-t, përfshirë edhe në ILA-t e organizuara si Gjykata të Llogarisë, e as për punën jo-Audituese të kryer nga ILA. ILA duhet të përcaktoj standardet e aplikueshme për punën e tillë për të siguruar që ajo punë është vazhdimisht e kualitetit të lartë (shih paragrafin 1.0.8).
- (b) ILA duhet të aplikoj gjykimin e vet ndaj situatës së ndryshueshme që mund të ketë lindur gjatë rrjedhës së auditimit qeveritar (shih paragrafin 1.0.15).
- (c) Me ngritjen e vetëdijes qytetare, kërkesa për përgjegjshmëri publike të personave apo entiteteve që menaxhojnë resurset publike është bërë gjithnjë e më e qartë, ashtu që ekziston nevojë më e madhe për vendosjen e një procesi të përgjegjshmërisë dhe që ai të funksionoj në mënyrë efektive (shih paragrafin 1.0.20).
- (d) Zhvillimi i sistemeve adekuate të informacionit, vlerësimit dhe raportimit në kuadër të qeverisë, do të ndihmojnë procesin e përgjegjshmërisë. Menaxhmenti është përgjegjës për korrektësinë dhe mjaftueshmërinë e formës dhe përmbajtjes së raporteve financiare dhe informatave tjera (shih paragrafin 1.0.23).
- (e) Autoritetet e duhura duhet të sigurojnë nxjerrjen e standardeve të pranueshme të kontabilitetit për raportimin financiar dhe shpалosjen përkatëse për nevoja të qeverisë, ndërsa entitetet e audituara duhet të zhvillojnë objektiva të caktuara dhe të matshme dhe caqe të përmbushjes (shih paragrafin 1.0.25).
- (f) Aplikimi i duhur i standardeve të pranueshme të kontabilitetit, duhet të rezultoi në prezantim të ndershëm të pozitës financiare dhe rezultateve të operacioneve (shih paragrafin 1.0.28).

- (g) Ekzistimi i një sistemi të duhur të kontrollit të brendshëm, e minimizon rrezikun për gabime dhe parregullsi (shih paragrafin 1.0.30).
- (h) Dekretet legislative do të mundësonin bashkëpunimin e entiteteve që auditohen në mbajtjen dhe ofrimin e qasjes në të gjitha të dhënat e rëndësishme, të nevojshme për një vlerësim gjithëpërfshirës të aktiviteteve që janë duke u audituar (shih paragrafin 1.0.32).
- (i) Të gjitha aktivitetet e auditimit duhet të jenë në kuadër të mandatit auditues të ILA-s (shih paragrafin 1.0.34)
- (j) ILA-të duhet të punojnë drejt përmirësimit të teknikave për auditimin e vlefshmërisë së masave të ekzekutimit/performancës (shih paragrafin 1.0.45).

1.0.7 Paragrafët vijues shpjegojnë rëndësinë e parimeve themelore të auditimit.

1.0.8 Parimet themelore të auditimit theksojnë se

ILA duhet të ketë parasysh respektimin e standardeve të auditimit të INTOSAI –t, në të gjitha çështjet që konsiderohen materiale. Disa standarde mund të mos jenë të aplikueshme në një numër të aktiviteteve që kryhen nga ILA-t, përfshirë ato të organizuara si Gjykata të Llogarive, dhe as për punën jo-audituese që kryhet nga ILA. ILA duhet të përcaktoj standardet e aplikueshme për punët e tilla, për të siguruar që ajo punë është vazhdimisht e një cilësie të lartë (shih paragrafin 1.0.6a).

1.0.9 Në përgjithësi, një çështje mund të gjykohet si materiale nëse njohja e saj do kishte të ngjarë të ndikoj shfrytëzuesin e pasqyrave financiare ose raportin e auditimit të performancës.

1.0.10 Materialiteti shpesh matet në aspekt të vlerës por lloji apo vetitë e vetvetishme të një artikulli apo grupi artikujsh, mund po ashtu të bëjnë një çështje të jetë materiale—për shembull, kur ligji apo rregullorja kërkon nga ajo të shpaloset ndaras, pavarësisht prej shumës në pyetje.

1.0.11 Përveç materialitetit sipas vlerës dhe llojit, një çështje mund të jetë materiale edhe për shkak të kontekstit në të cilin ajo shfaqet. Për shembull, të merret parasysh një çështje, në lidhje me:

- (a) pamjen e përgjithshme që i jep informacionit financiar;
- (b) totali i të cilës krijon një pjesë;
- (c) kushtet e ndërlidhura;
- (d) shumës përkatëse gjatë viteve të shkuara.

1.0.12 ILA-t shpesh kryejnë aktivitete që shikuar aspekti i përkufizimit të përpiktë, nuk kualifikohen si auditime, por të cilat kontribuojnë për një qeverisje më të mirë.

Shembuj të punës jo-audituese mund të përfshijnë (a) mbledhjen e të dhënave pa kryer analiza substanciale, (b) punë juridike, (c) misioni informues i Asamblesë së zgjedhur në lidhje me ekzaminimin draft buxheteve, (d) mision asistence për anëtarët e Asambleve të zgjedhura për sa i takon hetimit dhe shqyrtimit të dokumenteve (dosjeve) të ILA-ve, (e) aktivitete administrative dhe (f) funksioneve të proceduara me kompjuter.

Këto aktivitete jo-audituese sigurojnë informata të vlefshme për marrësit e vendimeve dhe duhet të jenë vazhdimisht të kualitetit të lartë.

1.0.13 Për shkak të qasjes dhe strukturës së disa nga ILA-ve, jo të gjitha standardet e auditimit janë të zbatueshme për të gjitha aspektet e punës së tyre. Për shembull, natyra kolegjiale dhe ligjore e rishikimeve të kryera nga Gjykatat e Llogarisë, i bëjnë aspektet e punës së tyre rrënjësisht të ndryshme nga auditimet financiare dhe të performancës të kryera nga ILA-të të cilat janë të organizuara në bazë të një sistemi hierarkik i udhëhequr nga Auditori i Përgjithshëm ose nga Kontrollori i Përgjithshëm “Comptroller General”.

1.0.14 Për të siguruar kryerjen e punës me kualitet të lartë, duhet ndjekur standardet e duhura. Objektivat e një lloji të veçantë të punës ose të një detyre të veçantë, duhet të përcaktojnë standardet e caktuara që duhet zbatuar. Çdo ILA duhet të themeloj një politikë mbi të cilën standardet e INTOSAI-t apo standardet e tjera të caktuara, duhet të zbatohen gjatë kryerjes së llojeve të ndryshme të punës që kryen organizata, për të siguruar që puna dhe rezultatet të jenë të një kualiteti të lartë.

1.0.15 Parimet themelore audituese theksojnë që

ILA duhet të aplikoj gjykimin e vet në situatat e ndryshueshme që mund të dalin gjatë Auditimit qeveritar (shih paragrafin 1.0.6b).

1.0.16 Dëshmia e auditimit luan një rol të rëndësishëm në vendimin e auditorit për përzgjedhjen e çështjeve dhe fushave për auditim dhe për llojin, momentin dhe gjerësinë e testeve dhe procedurave audituese.

1.0.17 Dispozitat/kushtet e mandatit auditues me të cilat është e pajisur ILA mbizotërojnë çdo konventë të kontabilitetit apo auditimit me të cilat ato bien ndesh, kështu që kanë ndikim vendimtar në standardet e auditimit që aplikon ILA.

Rrjedhimisht, standardet audituese të INTOSAI-t – dhe në fakt çdo standard i auditimit jashtë ILA-së, nuk mund të jetë autoritar, ose të kenë aplikim të obligueshëm nga ILA apo nga anëtarët e stafit të saj.

1.0.18 ILA duhet të gjykoj nivelin deri ku standardet e jashtme të auditimit përkrijnë me plotësimin e mandatit të ILA-së. ILA duhet të pranojë, megjithatë, se standardet e auditimit të INTOSAI-t simbolizojnë një konsensus të opinionit në mes të auditorëve qeveritar dhe duhet të mundohen t'i aplikojnë ato aty ku ato korrespondojnë me mandatin e ILA-së. ILA duhet të kërkoj largimin e papajtueshmërive aty ku kjo është e domosdoshme, për të lejuar miratimin e standardeve të dëshirueshme.

1.0.19 Për disa elemente të mandatit të ILA-së, veçanërisht në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, objektivat audituese të ILA-së mund të jenë të njëjta me objektivat e auditimit në sektorin privat. Gjithashtu, standardet e sektorit privat për auditimin e pasqyrave financiare, të cilat janë të shpallura nga agjencitë rregullatorë të zyrtarizuar, mund të jenë të aplikueshme për auditorin qeveritar (publik).

1.0.20 Parimet themelore të auditimit theksojnë që

Me ngritjen e vetëdijes publike, nevoja për përgjegjshmëri publike të personave apo subjekteve që menaxhojnë resurset publike është bërë gjithnjë më e madhe, ashtu që ekziston nevojë më e madhe për vendosjen e një procesi të përgjegjshmërisë i cili do të funksiononte në mënyrë efektive (shih paragrafin 1.0.6c)

1.0.21 Në disa shtete, janë të vendosur mekanizma të tillë që kërkojnë nga entitetet përgjegjëse të raportojnë te Presidenti, Monarku apo te Këshilli Shtetëror, por në shumicën e shteteve ato raportojnë te një ligjvënës i zgjedhur, drejtpërdrejt ose përmes degës ekzekutive të qeverisë. Një numër i caktuar i ILA-ve, kanë një status juridik. Autoriteti juridik ushtrohet, varësisht nga shteti, në lidhje me llogaritë, në lidhje me kontabilistët, ose edhe në lidhje edhe me administratorët. Gjykimet dhe vendimet që marrin këto institucione janë plotësime të zakonshme të funksionit të auditimit administrativ me çka ata janë të ngarkuar. Veprimet e tyre juridike duhet të shihen

si pjesë të logjikës së objektivave të përgjithshme të ndjekura nga auditimi i jashtëm dhe veçanërisht ato objektiva që ndërlidhen me çështje të kontabilitetit.

1.0.22 Ndërmarrjet publike po ashtu kërkojnë të përmbushin obligimet e kontabilitetit publik. Ndërmarrjet publike mund të përfshijnë sipërmarrje komerciale, p.sh., entitetet e themeluara me statut apo urdhër ekzekutiv ose në të cilat Qeveria ka një interes të llogaritur. Pavarësisht nga mënyra se si janë të strukturuar, funksioni i tyre, shkalla e autonomisë ose aranzhimet financiare, entitete të tilla janë në fund përgjegjëse para organit të lartë të nxjerrjes së ligjeve.

1.0.23 Parimet themelore të auditimit theksojnë që

Zhvillimi i sistemeve adekuate të informacionit, vlerësimit dhe raportimit në kuadër të qeverisë, do të ndihmojë procesin e përgjegjshmërisë. Menaxhmenti është përgjegjës për korrektësinë dhe mjaftueshmërinë e formës dhe përmbajtjes së raporteve financiare dhe informatave tjera (shih paragrafin 1.0.6d).

1.0.24 Korrektësia dhe mjaftueshmëria e raporteve dhe formulimeve financiare, janë shprehje e entitetit në lidhje me pozitën financiare dhe rezultatet e veprimeve. Është po ashtu obligim i entitetit që të hartoj një sistem praktik i cili do të sigurojë informata përkatëse dhe të besueshme.

1.0.25 Parimet themelore të auditimit theksojnë se

Autoritetet e duhura duhet të sigurojnë nxjerrjen e standardeve të pranueshme të kontabilitetit për raportimin financiar dhe shpalsjen përkatëse për nevoja të qeverisë, ndërsa entitetet e audituara duhet të zhvillojnë objektiva të caktuara dhe të matshme si dhe caqe të performancës (shih paragrafin 1.0.6e).

1.0.26 ILA-të duhet të punojnë me standardet e kontabilitetit që bëjnë që organizatat të ndihmojnë në garantimin e nxjerrjes së standardeve të duhura të kontabilitetit për qeverinë (sektorin publik).

1.0.27 ILA-të duhet po ashtu t'i rekomandojnë entiteteve të audituara që të nxjerrin objektiva të matshme dhe qartë të formuluar dhe që të formojnë caqe të performancës për këto objektiva.

1.0.28 Parimet themelore të auditimit theksojnë se

Aplikimi konsistent i standardeve të pranueshme të kontabilitetit, duhet të rezultoi në prezantim të drejtë të pozitës financiare dhe rezultateve të operacioneve (shih paragrafin 1.0.6f).

1.0.29 Supozimi se konsistenca gjatë aplikimit të standardeve të kontabilitetit është një parakusht i paanësisë, do të thotë se një entitet i audituar duhet të veprojë në zbatim standardeve të kontabilitetit të përshtatshme ndaj rrethanave dhe kërkesave për aplikimin e standardeve të tilla të kontabilitetit në mënyrë konsistente.

Auditori nuk duhet të trajtojë respektimin e standardeve të kontabilitetit në mënyrë konsistente si dëshmi definitive e prezantimit të drejtë të raporteve të ndryshme financiare. Paanësia është një shprehje e opinionit të auditorit, që shkon përtej kufijve të aplikimit konsistent të standardeve të kontabilitetit. Një supozim tillë nënvijëzon se standardet e auditimit nuk janë më shumë se një kërkesë minimale si obligim i auditorit. Mbetet në gjykimin e auditorit nëse të shkohet përtej atij minimum.

1.0.30 Parimet themelore të auditimit theksojnë se

Ekzistenca e një sistemi adekuat të kontrollit të brendshëm, minimizon rrezikun për gabime ose parregullsi (shih paragrafin 1.0.6g).

1.0.31 Është nën përgjegjësinë e entitetit të audituar që të vendos sisteme adekuate të kontrollit të brendshëm, për të mbrojtur resurset e saj. Kjo nuk është përgjegjësi e auditorit. Është po ashtu obligim i entitetit të audituar, që të siguroi se ekzistojnë kontrollat të vendosura dhe se ato janë funksionale për të ndihmuar në garantimin se statute dhe rregullore të aplikueshme janë duke u respektuar dhe se ndershmëria dhe përshtatshmëria respektohen gjatë marrjes së vendimeve. Megjithatë, kjo nuk e ndalon auditorin nga dorëzimi i propozimeve dhe rekomandimeve të entitetit i audituar kur është gjetur se kontrollat janë joadekuate ose mungojnë.

1.0.32 Parimet themelore të auditimit theksojnë se

Miratimet legjislative do të mundësonin bashkëpunimin e entiteteve të audituara në ruajtjen dhe sigurimin e qasjes për të gjitha të dhënat relevante, të domosdoshme për një vlerësim gjithëpërfshirës të aktiviteteve nën auditim (shih paragrafin 1.0.6h).

1.0.33 ILA duhet të ketë qasje në burimin e të dhënave dhe informatave si dhe qasje të zyrtarët dhe stafi i entitetit të audituar, në mënyrë që t'i kryejë si duhet përgjegjësitë e veta ndaj auditimit. Miratimi i kërkesave legjislative për qasje të

auditorit të këto informacione dhe për të personeli, do të ndihmojnë në minimizimin e problemeve në këtë fushë në të ardhmen.

1.0.34 Parimet themelore të auditimit theksojnë se

Të gjitha aktivitetet e auditimit duhet të jenë në kuadër të mandatit auditues të ILA-së (shih paragrafin 1.0.6i).

1.0.35 ILA-të kryesisht janë të themeluara nga organi më i lartë i nxjerrjes së ligjeve, ose përmes dispozitës kushtetuese. Në disa raste, elementet e rolit të ILA-së mund të jenë më parë sipas kushtetutës se sa sipas një dispozite përkatëse ligjore. Zakonisht ligji ose rregullorja themeluese përcakton formën e ILA-s (siç është gjykata, bordi, komisioni, zyra statutore ose ministria), kushtet dhe konditat e mandatit, pozitën, kompetencat, detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e përgjithshme dhe çështjet tjera që rregullojnë mbajtjen e zyrës dhe kryerjen e funksioneve dhe detyrave.

1.0.36 Çfarëdo qofshin mekanizmat, funksioni esencial i ILA-së është të mbajë dhe promovoj përgjegjshmërinë publike. Në disa shtete, ILA është gjykatë, e përbërë nga gjykatës, që ka autoritet mbi kontabilistët shtetëror, të cilët duhet t'i dorëzojnë llogaritë të ajo. Funksioni juridik kërkon që ILA të sigurohet se kushdo që është i ngarkuar të merret me fonde publike, është përgjegjës për to, dhe duke qenë kështu, është subjekt i juridiksionit të saj.

1.0.37 Ekziston një plotësim i rëndësishëm në mes të këtij autoriteti juridik dhe karakteristikave tjera të auditimit. Karakteristikat duhet të shikohen si pjesë e logjikës së objektivave të përgjithshme të ndjekura nga auditi i jashtëm dhe veçanërisht ato të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontabilitetit.

1.0.38 Fushëveprimi i plotë i auditimit qeveritar (publik) përfshinë auditimin e rregullsisë dhe të performancës.

1.0.39 Auditimi i rregullsisë përfshinë:

- (a) Verifikimin e përgjegjesisë financiare të entiteteve përgjegjëse, përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare dhe shprehjen e opinioneve në lidhje me pasqyrat financiare;
- (b) Verifikimin e përgjegjesisë financiare të administratës qeveritare në tërësi;

- (c) auditimin e sistemeve dhe transaksioneve financiare përfshirë vlerësimin e respektimit të statuteve të aplikueshme dhe rregulloreve
- (d) auditimin e kontrollit të brendshëm dhe funksioneve të auditit të brendshëm;
- (e) auditimin e ndershmërisë dhe përshtatshmërisë të vendimeve administrative të marra në kuadër të entitetit të audituar; dhe
- (f) raportimin e çfarëdo çështjeje tjetër që rrjedh nga ose ndërlihet me auditimin, për të cilën ILA mendon se duhet të shpaloset.

1.0.40 Auditimi i performancës ka të bëjë me auditimin e ekonomizimit, efikasitetit, efektivitetit dhe përfshinë:

- (a) auditimin e ekonomizimit të aktiviteteve administrative në përputhje me praktikatat dhe parimet e shëndosha administrative, dhe politikatat e menaxhmentit;
- (b) auditimin e efikasitetit të shfrytëzimit të resurseve njerëzore, financiare dhe të tjera, përfshirë ekzaminimin e sistemeve informative, masave të performimit dhe mekanizmave monitorues dhe procedurave të ndjekura nga entitetet e audituara për korrigjimin e të metave/mangësive të identifikuara; dhe
- (c) auditimin e efektivitetit të performancës për sa i takon arritjes së objektivave të entitetit të audituar dhe auditimin e ndikimit aktual të aktiviteteve në raport me ndikimin e synuar.

1.0.41 Në praktikë, mund të ketë një pikëtakim (shtrirje njëra mbi tjetrën) në mes të auditimit të rregullsisë dhe të performancës dhe në raste të tilla, klasifikimi i ndonjë auditimi të caktuar do të varet nga qëllimi parësor i atij auditimi.

1.0.42 Në shumë vende, mandati për auditim të performancës, do të ndaloj pa u kryer rishikimi i bazës së politikave të programeve qeveritare. Sido që të jetë, mandati duhet qartazi të paraqes kompetencat dhe përgjegjësitë e ILA-së për sa i takon auditimit të performancës në të gjitha fushat e aktivitetit qeveritar, në mes tjerash, për të lehtësuar aplikimin e standardeve të përshtatshme të auditimit nga ILA.

1.0.43 Në disa vende, kushtetuta apo legjislacioni në fuqi, nuk i japin gjithmonë autoritetin ILA-së për të audituar "efektivitetin" ose "efikasitetin" e menaxhimit financiar të Ekzekutivit. Në këto raste, vlerësimi i përshtatshmërisë ose leverdia e vendimeve administrative dhe efektiviteti i menaxhmentit mbetet te Ministrat, të cilëve iu jepet detyra e organizimit të shërbimeve administrative dhe të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e tyre para organit legjislativ. Shprehja që në këtë rast do të dukej të ishte më e përshtatshme për të shpjeguar auditimet e ILA-së të cilat shkojnë përtej kornizës së zakonshme të rregullsisë dhe vlefshmërisë, është ajo e "auditimit të menaxhimit të mirë." Një auditim i tillë synon të vazhdoj me një analizë të shpenzimeve publike, sipas parimeve të përgjithshme të menaxhimit të mirë. Dy llojet e auditimit—të rregullsisë dhe të menaxhimit—në praktikë mund të kryhen në kuadër të një veprimi, aq më tepër pasi që në mënyrë reciproke ato fuqizojnë: auditimet e rregullsisë, duke qenë në gjendje të përgatisin auditimet e menaxhimit dhe që më vonë rezultojnë në përmirësimin e gjendjeve që kanë shkaktuar parregullsi.

1.0.44 Përgjegjshmëria publike do të promovohet në mënyrë më efektive, atëherë kur mandati mundëson ILA-në të kryej, ose drejtoj kryerjen e auditimit të rregullsisë dhe të performancës së të gjitha ndërmarrjeve publike.

1.0.45 Parimet e përgjithshme të auditimit theksojnë se

ILA-t duhet të punojnë drejt përmirësimit të teknikave për auditimin e vlefshmërisë së veprimeve të performancës (shih paragrafin 1.0.6j).

1.0.46 Roli auditues që është duke u zgjeruar i auditorëve do të kërkoj nga ata të përmirësojnë dhe të zhvillojnë teknika dhe metodologji të reja për të vlerësuar nëse veprime/masa të arsyeshme dhe të vlefshme të performancës janë përdorur nga entiteti i audituar. Auditorët duhet të nxjerrin dobiti nga teknikat dhe metodologjitë të disiplinave tjera.

1.0.47 Fushëveprimi i mandatit auditues do të përcaktoj fushëveprimin e standardeve që do të aplikohen nga ILA.

Kreu II

2.1 Standardet e Përgjithshme të Auditimit Qeveritar (publik)

2.1.1 Kjo pjesë i referohet standardeve të përgjithshme në auditimin qeveritar. Standardet e përgjithshme të auditimit përshkruajnë kualifikimet e auditorit dhe/ose të institucionit të auditimit, në mënyrë që ato të mund të kryejnë detyrat e ndërlidhura me standardet e terrenit dhe raportimit në formë kompetente efektive.

2.1.2 Standardet e përgjithshme të auditimit ekzistojnë në mënyrë që ILA të miratoj politika dhe procedura për

- (a) Rekrutimin e personelit me kualifikime të përshtatshme (shih Paragrafin 2.1.3).
- (b) Zhvillimin dhe trajnimin e stafit të ILA-së, për t'i mundësuar ata që të formojnë detyrat e tyre në mënyrë efektive dhe të përcaktojnë bazën për avansimin e auditorëve dhe stafit tjetër (shih paragrafin 2.1.5).
- (c) Përgatitjen e doracakëve dhe direktivave dhe udhëzimeve tjera me shkrim në lidhje me kryerjen e auditimeve (shih paragrafin 2.1.13).
- (d) Mbështetjen e aftësive dhe përvojës në dispozicion në kuadër të ILA-së dhe për identifikimin e aftësive që mungojnë; të siguroj një shpërndarje të mire të aftësive në raport me detyrat audituese dhe të caktoj një numër të mjaftueshëm të stafit për secilin auditim; dhe posedimin e një plani dhe mbikëqyrje të duhur për të arritur qëllimet e veta në nivelin e duhur me kujdes të duhur (shih paragrafin 2.1.15).
- (e) Rishikoj efikasitetin dhe efektivitetin e standardeve dhe procedurave të brendshme të ILA-së (shih paragrafin 2.1.25).

2.1.3 Standardet e përgjithshme për ILA-t përfshijnë

ILA duhet të miratoj politika dhe procedura për të rekrutuar personelin që kanë kualifikimet e përshtatshme (shih paragrafin 2.1.2a).

Paragrafët vijues shpjegojnë rekrutimin si një standard të auditimit.

2.1.4 Personeli i ILA-së duhet të posedoj kualifikime të përshtatshme akademike dhe të jetë i pajisur me trajnime dhe përvojë të përshtatshme. ILA duhet të vendos/përcaktoj dhe rregullisht të rishikoi, kërkesat minimale edukative për përzgjedhjen e auditorëve.

2.1.5 Standardet e përgjithshme për ILA-në përfshijnë

ILA duhet të miratoi politika dhe procedura për të zhvilluar dhe trajnuar stafin e ILA-së, për t'i mundësuar ata që të kryejnë punën e tyre në mënyrë efektive dhe për të caktuar bazën për avancimin e auditorëve dhe stafit tjetër (shih paragrafin 2.1.2b).

Paragrafët vijues shpjegojnë trajnimin dhe zhvillimin si një standard të auditimit.

2.1.6 ILA duhet të ndërmerr hapa adekuat që të siguroj një zhvillim profesional të vazhdueshëm për personelin e vet, përfshirë, kur të shihet e përshtatshme, ofrimin e kurseve brenda institucionit dhe mbështetjen për ndjekjen e kurseve që organizohen jashtë institucionit.

2.1.7 ILA duhet të mbaj një regjistrim të aftësive të personelit, që do të ndihmonte gjatë planifikimit të auditimeve si dhe për të identifikuar nevojat për zhvillim profesional.

2.1.8 ILA duhet të vendos dhe rregullisht të rishikoi kriterin, përfshirë nevojat arsimore, për avancimin e auditorëve dhe stafit tjetër të ILA-së.

2.1.9 ILA duhet po ashtu të vendos dhe të disponoj politika dhe procedura për zhvillimin profesional të stafit auditues, për sa i takon teknikave dhe metodologjive të auditimit të aplikueshme për llojin e auditimeve që ajo ndërmerr.

2.1.10 Personeli i ILA-së duhet të ketë njohuri të avancuara mbi ambientin qeveritar, përfshirë aspekte siç janë roli i legjislaturës, mekanizmat ligjor dhe institucional që rregullojnë veprimet e ekzekutivit dhe aktet themeluese të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, stafi i trajnuar auditues duhet të posedoj një njohuri adekuate mbi standardet, politikat, procedurat dhe praktikat audituese të ILA-së

2.1.11 Auditimi i sistemeve financiare, të dhënave kontabël dhe pasqyrave financiare,

kërkon një trajnim në kontabilitet dhe në disiplinat përkatëse dhe njohuri mbi legjislacionin e aplikueshëm dhe urdhrat ekzekutiv që ndikojnë në përgjegjshmërinë e entitetit të audituar. Për më tepër, kryerja e auditimeve të performancës mund të kërkoj, si shtesë nga ajo e sipër-përmendur, trajnimin në fushat siç janë administrata, menaxhmenti, ekonomia dhe shkencat sociale.

2.1.12 ILA duhet të inkurajoj personelin e saj për të qenë anëtarë të një organi profesional që ka të bëjë me punën e tyre dhe të marr pjesë në aktivitetet e atij organi.

2.1.13 Standardet e përgjithshme për ILA-në përfshijnë:

ILA duhet të aprovoj politika dhe procedura për të përgatitur doracakë dhe direktiva dhe udhëzime tjera të shkruara që ndërlidhen me kryerjen e auditimeve (shih paragrafin 2.1.2c).

Paragrafi vijues shpjegon direktivat e shkruara si standard të auditimit.

2.1.14 Përcjellja te stafi i ILA-së i qarkoreve (udhëzimeve të brendshme) që përmbajnë direktiva dhe mbajtjen e një doracaku të azhurnuar auditimi që përcakton politikat, standardet dhe praktikat e ILA-së, është e rëndësishme në ruajtjen e kualitetit të auditimeve.

2.1.15 Standardet e përgjithshme për ILA-të përfshijnë

ILA duhet të miratoj politika dhe procedura për të mbështetur aftësitë dhe përvojën e disponueshme brenda ILA-së dhe të identifikoj aftësitë që mungojnë; të siguroj një shpërndarje të mirë të aftësive për detyrat audituese dhe një numër të mjaftueshëm të stafit për auditimet përkatëse; dhe të siguroi një planifikim dhe mbikëqyrje të duhur për të arritur synimet e saj në nivelin e kërkuar të kujdesit dhe shqetësimit të duhur (shih paragrafin 2.1.2d).

Paragrafët vijues sqarojnë shfrytëzimin e aftësive si një standard të auditimit.

2.1.16 Resurset e nevojitur për të kryerjen e çdo auditimi duhet të vlerësohen në mënyrë që stafi që posedon aftësitë e duhura, të mund të caktohen në detyrë dhe që të aplikohet një kontroll mbi resurset e stafit që i dedikohen auditimit

2.1.17 Niveli deri ku arrijtjet akademike duhet të ndërlidhen në mënyrë specifike me detyrën audituese, ndryshon varësisht nga lloji i auditimit të ndërmarrë. Nuk është e nevojshme që secili auditor të posedoj aftësi në të gjitha aspektet e mandatit të auditimit. Megjithatë, politikat dhe procedurat që rregullojnë caktimin e personelit ndaj detyrave audituese, duhet të synojnë që të shpërndajnë personelin

me aftësitë e kërkuara të auditimit ndaj llojit përkatës të detyrës audituese, në mënyrë që ekipi i përfshirë në një auditim të caktuar, kolektivisht të posedoj aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme.

2.1.18 Duhet të varet nga ILA që të siguroi aftësi të specializuara nga burimet e jashtme, nëse kështu e kërkon kryerja e suksesshme e një auditimi, në mënyrë që të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit të jenë të perceptueshme dhe mirë të mbështetura dhe po ashtu të reflektojnë një të kuptuar adekuat të fushës së subjektit të auditimit. Mbetet në përgjegjësinë e ILA-së të gjykoj, në rrethanat e veta të veçanta, se deri në çfarë mase kërkesat e saj janë më së miri të realizueshme nga ekspertiza e brendshme (e institucionit, krahasuar me angazhimin e ekspertëve nga jashtë).

2.1.19 Politikat dhe procedurat që rregullojnë mbikëqyrjen e auditimeve janë faktorë të rëndësishëm në ekzekutimin e rolit të ILA-së në një nivel të duhur. ILA duhet të siguroi që auditimet të planifikohen dhe mbikëqyren nga auditorët të cilët janë të aftë, njohin standardet dhe metodologjitë e ILA-së dhe të pajisur me një të kuptuar të veçoritë dhe të veçantat e ambientit.

2.1.20 Aty ku mandati i ILA-së përfshinë auditimin e pasqyrave financiare të cilat përfshijnë degën ekzekutive të qeverisë si tërësi, ekipet e auditimit të shpërndara, duhet të jenë të pajisura për të kryer një vlerësim të bashkërenduar të sistemeve kontabël të departamentit, si dhe të aranzhimeve bashkërenduese dhe mekanizmave të kontrollit të agjencisë qendrore. Ekipet do të kërkojnë të kenë njohuri mbi sistemet relevante të kontabilitetit dhe të kontrollit të qeverisë, dhe një ekspertizë të duhur në lidhje me teknikat e auditimit që aplikohen nga ILA për këtë lloj të auditimit.

2.1.21 Përveç nëse ILA është e pajisur për të ndërmarrë, brenda një afati të arsyeshëm, të gjitha auditimet relevante përfshirë edhe auditimet e performancës që mbulojnë të gjitha aktivitetet e të gjitha entiteteve që auditohen, nevojitet një kriter për të përcaktuar shkallën e aktiviteve të auditimit të cilat, brenda afatit apo ciklit të auditimit, do të japin sigurimin maksimal praktik për sa i takon përmbushjes së obligimit për përgjegjshmëri publike të secilit entitet të audituar.

2.1.22 Gjatë përcaktimit të alokimit të resurseve të saj nëpër aktivitete në ndryshme të auditimit, ILA duhet t'i jap përparësi atyre detyrave audituese të cilat duhet, në bazë të ligjit, të kompletohen brenda një afati të caktuar kohor. Kujdes i veçantë duhet kushtuar planifikimit strategjik ashtu që të identifikoi një rend të përshtatshëm të përparësive për auditimet opcionale që duhet të ndërmarr.

2.1.23 Caktimi i prioriteteve në harmoni me mbajtjen e kualitetit të ekzekutimit sipas mandatit, përfshin aplikimin e gjykimit të ILA-së mbi bazë të informacionit të disponueshëm. Mbajtja e një grumbulli të dhënash që kanë të bëjnë me strukturën, funksionet dhe aktivitetet e entiteteve të audituara, do të ndihmonte ILA-në në përcaktimin e fushave materiale dhe të dobëta (të cenueshme) dhe fushat që zotërojnë potencial për përmirësime në administrim.

2.1.24 Para se të ndërmerret çdo auditim, autorizim i duhur për fillimin e tij duhet të jepet nga stafi i caktuar në kuadër të ILA-së. Ky autorizim duhet të përfshijë një formulim të qartë të objektivave të auditimit, fushëveprimin dhe fokusimin e tij, resurset që do të aplikohen gjatë auditimit për sa i takon aftësive dhe kuantitetit, mekanizmat që duhet të vendosen për rishikime në lidhje me progresin e bërë në pika të caktuara dhe afatet deri në të cilat duhet të përfundohet puna audituese në terren dhe të bëhet shkrimi i raportit të auditimit.

2.1.25 Standardet e përgjithshme për ILA-t përfshijnë

ILA duhet të miratoi/nxjerr politika dhe procedura për të rishikuar efikasitetin dhe efektivitetin e standardeve dhe procedurave të brendshme të ILA-së (shih paragrafin 2.1.2e).

Paragrafët vijues sqarojnë rishikimet për garantimin e kualitetit, si një standard të auditimit.

2.1.26 Për shkak të rëndësisë së sigurimit të një standardi të lartë të punës nga ana e ILA-së, ajo duhet t'i kushtoj një rëndësi të veçantë programeve për kontrollim të kualitetit në mënyrë që të përmirësoj ekzekutimin dhe rezultatet e auditimit. Përfitimet që nxirren nga programe të tilla, e bëjnë esenciale për resurset e duhura të jenë të disponueshme për këtë qëllim. Është e rëndësishme që përdorimi i këtyre resurseve të përshtatet në raport me përfitimet që synohen të arrihen.

2.1.27 ILA duhet të vendos sisteme dhe procedura që të:

- (a) vërtetoj se tërë proceset e sigurimit të kualitetit kanë funksionuar në mënyrë të kënaqshme
- (b) siguroi kualitetin e raportit të auditimit; dhe
- (c) ruaj përmirësimet dhe të shmang përsëritjen e të metave.

2.1.28 Si mjete shtesë për sigurimin e kualitetit të ekzekutimit të auditimit, tjera nga rishikimi i aktivitetit të auditimit nga personeli që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për auditimet përkatëse, është e preferueshme që ILA-t të vendosin mekanizmat e tyre të kontrollit të kualitetit.

Është fjala që planifikimi, kryerja dhe raportimi në lidhje me një mostër të auditimeve, mund të rishikohet në thellësi nga personeli i kualifikuar si duhet i ILA-së i cili nuk është i përfshirë në ato auditime, në konsultim me menaxhmentin përgjegjës direkt për auditimin, për sa i takon rezultatit të mekanizmave të sigurimit të kontrollit të brendshëm dhe raportimit periodik të menaxhmenti i lartë i ILA-së.

2.1.29 Është në rregull që ILA të themeloj funksionin e saj të auditit të brendshëm, me një statut të gjerë, për të ndihmuar ILA-në të realizon një menaxhim efektiv për funksionet e saj dhe të mbështes kualitetin e performimit të vet.

2.1.30 Kualiteti i punës së ILA-së mund të avancoj përmes konsolidimit të rishikimit të brendshëm dhe ndoshta edhe përmes vlerësimit të pavarur të punës së saj.

2.1.31 Në disa vende, auditimi i rregullsisë dhe i ligjshmërisë merr formën e kontrollit evitues mbi shpenzimet publike, duke nënkuptuar aprovimin e shpenzimit nga ana e ILA-së.

2.1.32 Në përgjithësi, auditimi evitues duhet të kuptohet si një auditim i cili kryhet në një kohë, ku akoma i lejohet institucionit të auditimit të evitoj një veprim i cili gjykohet të jetë i parregullt.

2.1.33 Përderisa auditimi "a posteriori" vetëm mund të gjej parregullsitë kur ato tanimë kanë ndodhur dhe kur është më e vështirë të përmirësohen, auditimi "a priori", për dallim sjell një sanksion të menjëhershëm: refuzimin për të autorizuar pagesën në rast të parregullsisë juridike apo kontabël të vërtetuar nga ILA.

2.1.34 Disa ILA ndihmojnë në hartimin dhe/ose rishikimin dhe aprovimin e sistemeve kontabël dhe pastaj më vonë rishikojnë aplikimin të sistemeve të njëjta gjatë funksionimit.

2.1.35 ILA duhet të siguroi se respektohen standardet e aplikueshme si gjatë auditimeve paravajtëse (pre-audits) ashtu edhe gjatë atyre prapavajtëse (post-audits) dhe se shmangiet nga standardet të cilat përcaktohen të jenë të duhura, të dokumentohen.

2.2 Standardet me Domethënie Etike

2.2.1 Standardet e përgjithshme të auditimit përfshijnë:

- (a) Auditori dhe ILA duhet të jenë të pavarur (shih paragrafin 2.2.2).
- (b) ILA-të duhet të shmangin konfliktin e interesit në mes të auditorit dhe entitetit që auditojnë (shih paragrafin 2.2.31).
- (c) Auditori dhe ILA duhet të posedojnë aftësitë e kërkuara (shih paragrafin 2.2.33).
- (d) Auditori dhe ILA duhet t'i kushtojnë kujdes dhe rëndësi të duhur zbatimit të standardeve audituese të INTOSAI-t. Kjo nënkupton kujdes të duhur gjatë planifikimit, cilësimit, mbledhjes dhe vlerësimit të dëshmisë dhe gjatë raportimit të të gjeturave, konkluzioneve dhe rekomandimeve (shih paragrafin 2.2.39).

Pavarësia

2.2.2 Standardet e përgjithshme për auditorin dhe ILA-në përfshijnë

Auditori dhe ILA duhet të jenë të pavarur (shih paragrafin 2.2.1a).

Paragrafët vijues e shpjegojnë pavarësinë të jetë një standard i auditimit. Në veçanti, paragrafët 2.2.5 - 2.2.12 shpjegojnë pavarësinë nga aspekti legjislativ, paragrafët 2.2.13 - 2.2.24 nga aspekti ekzekutiv dhe paragrafët 2.2.25 - 2.2.29 nga aspekti i entitetit të audituar.

2.2.3 Çfarëdo qoftë forma e qeverisjes, nevoja për pavarësi dhe objektivitet gjatë auditimit është thelbësore. Një shkallë adekuate e pavarësisë si nga organi legjislativ ashtu edhe nga dega ekzekutive e qeverisë, është thelbësore për kryerjen e auditimit dhe për besueshmërinë e rezultateve të tij.

2.2.4 Kriteri për themelimin dhe për ruajtjen e pavarësisë së duhur të ILA-së, shumë lehtë mund të bëhet i qartë për shtetet ku ka një legjislativ të zgjedhur, të ndarë nga dega ekzekutive e qeverisë (pavarësisht nëse anëtarët e qeverisë janë ose nuk janë anëtarë të këtij organi legjislativ).

Pasi që pjesa më e madhe e mekanizmave të këtij lloji funksionojnë gjerësisht në shtetet anëtare të INTOSAI-t, këto standarde përcaktojnë kriteret për pavarësinë e ILA-së për shtetet me mekanizma të këtillë, duke pranuar që modifikimi dhe adoptimi i këtyre kriterëve do të jetë i domosdoshëm në shtetet tjera.

2.2.5 Legjislativi është njëri nga përdoruesit kryesor të shërbimeve të ILA-së. Kushtetuta apo legjislacioni e përcaktojnë që ILA të zhvilloi vet mandatin e saj dhe një tipar i shpeshtë i funksionit të ILA-së është raportimi i saj para legjislativit. Nga ILA mund të pritët të bashkëpunoj së afërmi me legjislativin, përfshirë edhe punën me çfarëdo komisioni të autorizuar nga legjislativi për tu marr me raportet e ILA-së. Një bashkërendim i këtillë mund t'i kontribuoj përcjelljes efektive të punës së ILA-së.

2.2.6 Në mënyrë të ngjashme, rezultatet e rëndësishme të auditimeve të realizimit të buxhetit shtetëror dhe administrimit dhe konflikteve dhe mosmarrëveshjeve me administratat e audituara, duhet të sillen në vëmendjen e organit legjislativ përmes raportimit apo komunikimit të veçantë.

2.2.7 Komisionet e veçanta të formuara në kuadër të organit legjislativ, në prani të Ministrave, të dërguarve nga shërbimet (entitetet) e audituara dhe përfaqësuesve të tjerë, mund të ngarkohen me ekzaminimin e përmbajtjes së raporteve të ILA-së dhe komunikimeve tjera të veçanta. Lidhja e ngushtë në mes të organit legjislativ dhe ILA-së mund po ashtu të implementohet përmes një hetimi buxhetor si dhe përmes asistencës teknike dhënë punës së komisionit parlamentar të ngarkuar me ekzaminimin e projekt buxheteve.

2.2.8 ILA mund t'i jap anëtarëve të legjislativit informata faktike mbi raportet e auditimit, por është e rëndësishme që ILA të ruaj pavarësinë e saj ndaj ndikimit politik, në mënyrë që të mbaj një qasje neutrale ndaj përgjegjësive audituese të saj. Kjo nënkupton që ILA të mos përgjigjet dhe po ashtu të mos duket se përgjigjet, ndaj nevojave të interesave të caktuar politik.

2.2.9 Përderisa ILA duhet të respektoj ligjet e miratuara nga legjislativi, pavarësia e duhur kërkon që ajo të mos jetë subjekt i qeverisjes nga legjislativi për sa i takon programimit, planifikimit dhe kryerjes së auditimeve. ILA nevojitet të jetë e lirë për të përcaktuar prioritetet e saj dhe që të programoj punën e saj në përputhje me mandatin e saj dhe të miratoi metodologjitë e duhura për auditimet që pritët të ndërmerren.

2.2.10 Në disa vende, auditimi i menaxhimit financiar të ekzekutivit është privilegj i Parlamentit apo e Asamblesë së zgjedhur; kjo mund të jetë po ashtu për sa i takon auditimit të shpenzimeve dhe të hyrave në një nivel rajonal, aty ku auditimi i jashtëm është përgjegjësi e asamblesë legjislative. Në këto raste auditimet kryhen në emër

të atij organi dhe është e përshtatshme që ILA të marrë parasysh kërkesat e saj për hetime të veçanta gjatë programimit të detyrave të saj audituese.

Megjithatë, është e rëndësishme që ILA të jetë e lire për të përcaktuar mënyrën në të cilën ajo e kryen gjithë punën e saj, përfshirë edhe ato detyra që kërkohen nga Parlamenti.

2.2.11 Do ishte e duhur që legjislativi të specifikoi kërkesat minimale të raportimit, përfshirë çështjet që do jenë subjekt i dhënies së opinionit të auditimit dhe të jap një afat të arsyeshëm brenda të cilit duhet të nxirreshin raportet. Përveç kësaj, mekanizma fleksibil për raportimin e ILA-së para legjislativit, pa pasur kufizime në përmbajtjen ose në kohë për raportet, do të mbështesnin ruajtjen e pavarësisë.

2.2.12 Është e domosdoshme që legjislativi t'i siguroi ILA-së resurse të mjaftueshme, për të cilat ILA është përgjegjëse siç është edhe për ushtrimin efektiv të mandatit të saj.

2.2.13 Dega ekzekutive e qeverisë dhe ILA mund të kenë interesa të përbashkëta në promovimin e përgjegjshmërisë publike. Por marrëdhënia kryesore me ekzekutivin është ajo e auditorit të jashtëm. Si e tillë, raportet e ILA-së ndihmojnë ekzekutivin duke tërhequr vëmendjen te dobësitë në administrim dhe duke dhënë rekomandime për përmirësim. Duhet pasur kujdes për të shmangur pjesëmarrjen në funksione ekzekutive të atij lloji që do të rrezikonin pavarësinë dhe objektivitetin e ILA-së gjatë kryerjes së mandatit të saj.

2.2.14 Është e rëndësishme për pavarësinë e ILA-së që ekzekutivi të mos ketë autoritet ndikues për sa i takon ekzekutimit të mandatit të saj nga ILA. ILA nuk duhet të obligohet të kryej, modifikoi ose të përmbahet nga kryerja e një auditimi ose të mbaj në fshehtësi apo të ndryshoj të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

2.2.15 Një shkallë e bashkëpunimit në mes të ILA-së dhe ekzekutivit është e dëshirueshme në disa fusha. ILA duhet të jetë e gatshme të këshilloi/informoi ekzekutivin për çështje siç janë standardet dhe politikat e kontabilitetit dhe forma e pasqyrave financiare. ILA duhet të sigurohet që në dhënien e këshillave/informatave të tilla, të shmangë çfarëdo zotimi specifik apo të nënkuptuar që do të dëmtoj pavarësinë gjatë ushtrimit të mandatit të saj auditues.

2.2.16 Ruajtja e pavarësisë së ILA-së nuk përjashton kërkesat për ILA-në që vijnë nga ekzekutivi dhe që propozojnë çështjet për auditim. Por, nëse do dëshironte të gëzonte pavarësi të duhur, ILA duhet të jetë në gjendje të hedh poshtë çfarëdo

kërkese të tillë. Është thelbësore për konceptin e pavarësisë së ILA-së, që vendimet që merren në lidhje me detyrat audituese që përbëjnë programin, të mbesin përfundimisht nën përgjegjësi të ILA-së.

2.2.17 Një fushë e ndjeshme në marrëdhëniet në mes të ILA-së dhe ekzekutivit, ka të bëjë me sigurimin e resurseve për ILA-në. Në shkallë të ndryshme, që reflektojnë dallimet kushtetuese dhe institucionale, mekanizmat për sigurimin e resurseve për ILA-në mund të kenë të bëjnë me situatën financiare të degës ekzekutive të qeverisë dhe me politikat e përgjithshme për shpenzime. Krejt në kundërshtim me këtë, promovimi efektiv i përgjegjshmërisë publike kërkon që ILA të pajiset me burime të mjaftueshme për ta mundësuar atë të kryej përgjegjësitë e saj në një mënyrë të arsyeshme.

2.2.18 Çdo situatë imponuese për shkak të resurseve ose kufizimeve tjera nga ana e ekzekutivit, që do të kufizonte ILA-në në kryerjen e mandatit të saj, do të ishte një çështje e duhur për tu raportuar te legjislativi nga ILA.

2.2.19 Mandati juridik duhet të siguroi qasje të plotë dhe të lirë nga ILA në të gjitha objektet dhe të dhënat relevante për entitetet e audituara dhe veprimet e tyre dhe po ashtu duhet të siguroi kompetenca të duhura për ILA-në të siguroi të dhënat relevante nga personat apo entitetet që i posedojnë ato.

2.2.20 Njashtu, sipas dispozitës apo marrëveshjes juridike, ekzekutivi duhet t'i lejoj qasje ILA-së në informacionet e ndjeshme të domosdoshme dhe relevante, në mënyrë që ILA të shkarkoj përgjegjësitë e saj.

2.2.21 Kushtet e angazhimit për kreun e ILA-së mund t'i kontribuojnë pavarësisë së ILA-së nga ekzekutivi, për shembull përmes emërimit për një afat të caktuar kohor (mandate të fiksuara kohor) ose deri në moshën e caktuar të pensionimit. Anasjelltas, kushtet e angazhimit të cilat e vendosin një ILA nën presion për të kënaqur ekzekutivin do të kishin një ndikim eroziv në pavarësinë e ILA-së. Për këtë arsye, në parim, rekomandohet që dispozitat që ndërlidhen me ndërprerjen e angazhimit ose largimin nga detyra, duhet të jenë të aplikueshme vetëm përmes një procesi të veçantë i ngjashëm me atë që ndërlidhet me mbajtësit e zyrës ligjore apo të ngjashme.

2.2.22 Për ato ILA të cilat ushtrojnë një funksion juridik dhe të cilat, në shumicën e rasteve, janë të organizuara si forma kolegjiale, pavarësia e anëtarëve të tyre duhet të sigurohet përmes garancive të ndryshme, veçanërisht parimit të pa-ndërrueshmërisë së gjykatësve, privilegjit të juridiksionit, përcaktimit të trajtimit nga ligji dhe pavarësisë së ekzaminimit të gjyqtarit.

2.2.23 Me qëllim që ILA jo vetëm të ushtroj funksionin e saj në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi por edhe të duket se është duke e bërë atë, është me rëndësi që mandati i saj dhe statusi i saj i pavarur, të kuptohen drejt nga komuniteti. ILA duhet, kur të shfaqen mundësitë e përshtatshme, të ndër marr një rol informues për sa i takon kësaj.

2.2.24 Pavarësia vepruese e ILA-së nuk duhet të përjashtoj aranzhimet/marrëveshjet me entitetet ekzekutive për sa i takon administrimit të ILA-së në çështjet siç janë marrëdhëniet e punës, menaxhimi i personelit, menaxhimi i pronës ose blerja e zakonshme e pajisjeve dhe furnizimeve, edhe pse entitetet ekzekutive nuk duhet të vijnë në pozitë të marrin vendime të cilat do të rrezikonin pavarësinë e ILA-së në ekzekutimin e mandatit të saj.

2.2.25 ILA duhet të mbetet e pavarur nga entitetet që auditohen. Megjithatë, ajo duhet të mundohet të krijoj në mesin e entiteteve të audituara, një kuptim mbi rolin dhe funksionin e saj, me qëllim të mbajtjes së marrëdhënieve shoqërore me to.

Marrëdhëniet e mira mund të ndihmojnë ILA-në të siguroi të dhëna lirshëm dhe në mënyrë të sqartë dhe të kryej diskutime në një atmosferë të respektit dhe kuptimit të ndërsjellë. Në këtë frymë, ILA, duke e ruajtur pavarësinë e saj, mund të pajtohet të jetë e kyçur në reformat të cilat planifikohen nga Administrata në fushat siç janë llogaritë publike ose legjislacioni financiar apo të pajtohet të konsultohet në lidhje me përgatitjen e projekt ligjeve apo rregullave që ndikojnë në mundësinë apo autoritetin e saj. Në këto raste, nuk është çështje e ndërhyrjes së ILA-së në menaxhimin administrativ por çështje e bashkëpunimit me shërbime të caktuara administrative, duke iu dhënë atyre asistencë teknike ose duke vendosur ekspertizën e menaxhimit financiar të ILA-së në dispozicion të tyre.

2.2.26 Ndryshe nga auditimi në sektorin privat ku detyra e pranuar nga auditori është e specifikuar në letrën e angazhimit, entiteti i audituar nuk është në marrëdhënie klienti me ILA-në. ILA duhet të kryej mandatin e saj lirshëm dhe paanësisht, duke marr parasysh pikëpamjet e menaxhmentit gjatë formimit të opinionit auditues, nxjerrjes së konkluzioneve dhe dhënies së rekomandimeve, por duke mos pasur asnjë obligim për dhënie përgjegjësish menaxhmentit të entitetit të audituar, në lidhje me fushëveprimin apo llojin e auditimeve të ndërmarra.

2.2.27 ILA nuk duhet të marrë pjesë në menaxhimin e operacioneve të entitetit që auditohet. Anëtarët e stafit auditues nuk duhet të bëhen anëtarë të komisioneve të menaxhmentit dhe nëse duhet të jepet këshillë audituese, ajo duhet të përcillet si këshillë apo rekomandim auditues dhe të kuptohet qartazi si e tillë.

2.2.28 Çdo anëtarë i personelit të ILA-së që ka lidhje/marrëdhënie të afërta me menaxhmentin e entitetit që auditohet, lidhje siç janë ato sociale,

marrëdhënie familjare apo marrëdhënie të tjera që favorizojnë zvogëlimin e objektivitetit, nuk duhen të caktohen për të audituar në atë entitet.

2.2.29 Personeli i ILA-së nuk duhet të kyçet t'i shpjegoj personelit të entitetit të audituar se cilat janë detyrat e tyre. Në ato raste ku ILA vendos të formoj një zyrë qëndrimi te entiteti i audituar me qëllim të lehtësimit të rishikimit vazhdues të operacioneve, programeve dhe aktiviteteve të saj, personeli i ILA-së nuk duhet të përfshihet në asnjë proces vendimmarrës apo aprovues, i cili konsiderohet përgjegjësi e menaxhmentit të entitetit të audituar.

2.2.30 ILA mund të bashkëpunoj me institucione akademike dhe të futet në marrëdhënie formale me organizmat profesional, me qëllim që të nxjerr dobi nga këshilla e anëtarëve me përvojë profesionale dhe që nuk janë personeli i saj, nëse këto marrëdhënie nuk ndikojnë negativisht në pavarësinë dhe objektivitetin e saj.

Konflikti i interesave

2.2.31 ILA-t duhet të shmangin konfliktin e interesave në mes të auditorit dhe entitetit që auditohet (shih paragrafin 2.2.1b).

2.2.32 ILA ekzekuton rolin e saj duke kryer auditime të entiteve që janë përgjegjëse dhe raportojnë rezultatet. Për të përmbushur këtë rol, ILA duhet të ruaj pavarësinë dhe objektivitetin e saj. Aplikimi i standardeve të duhura të përgjithshme të auditimit ndihmon ILA-në të përmbush këto kërkesa.

Aftësia

2.2.33 Standardet e përgjithshme për auditorin dhe ILA-në përfshijnë

Auditori dhe ILA duhet të posedojnë aftësitë e kërkuara (shih paragrafin 2.2.1c).

Paragrafët vijues shpjegojnë aftësinë si një standard të auditimit.

2.2.34 Mandati i ILA-së në përgjithësi shkakton një detyrë të formimit dhe raportimit të opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të auditimit. Në disa ILA kjo detyrë mund t'i imponohet kreut të organizatës. Në ILA-të e organizuara mbi bazë kolegjiale, detyra zakonisht vendoset mbi vet institucionin.

2.2.35 Diskutimi në kuadër të ILA-së promovon objektivitetin dhe autoritetin e opinioneve dhe vendimeve. Aty ku ILA është e strukturuar në formë kolegjiale, opinionet dhe vendimet përfaqësojnë pikëpamjen e organizatës si tërësi, edhe nëse veprimi është ndërmarrë ose ushtruar në trupat e ndryshuar nga përmbajtja por jo edhe nga autoriteti i tyre—për shembull, Dhoma, Dhoma e Bashkuar apo një pjesë e Dhomës. Nëse ILA ka vetëm një kryesues, të gjitha opinionet dhe vendimet merren nga ai ose në emër të tij.

2.2.36 Pasi që detyrat dhe përgjegjësitë kështu të mbartura nga ILA janë vendimtare për konceptin e përgjegjshmërisë publike, ILA për auditimet e saj, duhet të aplikoj metodologjitë dhe praktikat e kualitetit më të lartë. Është detyrë e saj të formuloj procedurat për të siguruar ushtrim efektiv të përgjegjësive të saj për raportet e auditimit, që nuk ndikohen dhe paraqesin zbatim të plotë nga ana e personelit apo ekspertëve të jashtëm, të standardeve të saja, procedurave të planifikimit, metodologjive dhe mbikëqyrjes.

2.2.37 ILA duhet të zotëroj një diapazon të aftësive dhe përvojës të domosdoshme për një kryerje efektive të mandatit të auditimit. Çfarëdo qoftë lloji i auditimeve që duhet të ndërmerren nën at mandat, puna audituese duhet të kryhet nga persona edukimi dhe përvoja e të cilëve përshtatet me llojin, fushëveprimin dhe kompleksitetin e detyrës audituese. ILA duhet të pajisë veten me diapazonin e plotë të metodologjive audituese të kohës së fundit, përfshirë teknikat e bazuara në sisteme, metodat e rishikimit analitik, mostrimin statistikor dhe auditimin e sistemeve të automatizuara të informacionit.

2.2.38 Sa më i gjerë dhe më opcional (fleksibil) të jetë lloji i mandatit të ILA-së, aq më kompleks bëhet detyra e garantimit të kualitetit të performimit gjatë mandatit. Kështu, një mandat që lë lirinë e zgjedhjes së ILA-së të varet nga shpeshësia e auditimeve që duhet të kryhen dhe nga lloji i raporteve që duhet të nxirren, kërkon një standard të lartë të menaxhimit brenda ILA-së.

Kujdesi i Duhur

2.2.39 Standardet e përgjithshëm për auditorin dhe ILA-në përfshijnë

Auditori dhe ILA duhet t'i kushtojnë kujdes dhe rëndësi të duhur zbatimit të standardeve audituese të INTOSAI-t. Kjo nënkupton kujdes të duhur gjatë planifikimit, cilësimit, mbledhjes dhe vlerësimit të dëshmisë dhe gjatë raportimit të të gjeturave, konkluzioneve dhe rekomandimeve (shih paragrafin 2.2.1d).

Paragrafët vijues shpjegojnë kujdesin e duhur si një standard të auditimit.

2.2.40 ILA duhet të jetë, dhe të duket se është, objektive në auditimin e saj të entiteteve dhe ndërmarrjeve publike. Duhet të jetë e paanshme gjatë vlerësimit dhe raportimit të rezultateve të auditimit të saj.

2.2.41 Performimi dhe ushtrimi i aftësive teknike duhet të jetë e kualitetit të tillë që t'i përshtatet kompleksitetit së një auditimi të veçantë. Auditorët duhet të jenë vigjilent për situatat si, dobësitë e kontrollit, papërshtatshmërisë në mbajtjen e të dhënave, gabime dhe transaksione apo rezultate të pazakonta të cilat do mund të ishin sugjeruese të mashtrimit, të shpenzimeve të pavenda ose të jashtëligjshme, operacioneve të paautorizuara, humbjes, joefikasitetit ose mungesës së ndershmërisë.

2.2.42 Aty ku një entitet i autorizuar apo i njohur përcakton standardet ose direktivat për kontabilitet dhe raportim nga ndërmarrjet publike, ILA mund të shfrytëzoj direktiva të tilla gjatë ekzaminimit të saj.

2.2.43 Nëse ILA angazhon ekspertë të jashtëm si këshilltarë, ajo duhet të ushtroi kujdes të duhur për të bindur veten mbi aftësitë e këshilltarëve dhe zotësitë që ata kanë për detyrat e caktuara ku ata do të përfshihen. Ky standard vlen edhe atëherë kur auditorët e jashtëm janë të angazhuar në kontratë me ILA-në. Për më tepër, kujdes duhet pasur për të siguruar që kontratat e auditimit përfshijnë në vete dispozita të përshtatshme për ILA-në që të përcaktoj planifikimin, fushëveprimin e auditimit, ekzekutimin dhe raportimin mbi auditimin.

2.2.44 Në rast se ILA, gjatë ekzekutimit të funksioneve të saj, do ketë nevojë të kërkoj këshillë nga specialistët jashtë saj, standardet për ushtrimin e kujdesit të duhur nën kushte të këtylla, kanë ndikim njashtu në ruajtjen e kualitetit të ekzekutimit. Marrja e këshillave nga një ekspert i jashtëm, nuk ia heq përgjegjësinë ILA-së për formimin e opinioneve apo nxjerrjen e konkluzioneve për detyrën audituese.

2.2.45 Atëherë kur ILA shfrytëzon punën e auditor-it-ve tjetër/tjerë, ajo duhet të aplikoj procedura adekuate për të ofruar garanci që auditorët tjerë kanë ushtruar kujdes të duhur dhe kanë vepruar në përputhje me standardet relevante të auditimit dhe mund të rishikojnë punën e auditorëve tjerë për të siguruar veten në lidhje me kualitetin e asaj pune.

2.2.46 Të dhënat në lidhje me entitetin që auditohet, të siguruara gjatë rrjedhës së punës së auditorit, nuk bën të shfrytëzohen për qëllime tjera nga fushëveprimi i auditimit dhe formimi i një opinioni ose raportimi në përputhje me përgjegjësitë e auditorit. Është esenciale që ILA të ruaj fshehtësinë për sa i përket çështjeve dhe informatave të auditimit, që rrjedhin nga detyra e saj audituese.

Megjithatë, ILA duhet të ketë të drejtë të raportoj shkeljet e ligjit pranë autoriteteve ndjekëse.

Kreu III

Standardet e Terrenit të Auditimit Qeveritar

3.0.1 Qëllimi i standardeve të terrenit është të formohet kriteri apo korniza e përgjithshme për hapa apo veprime të qëllimshme, sistematike dhe të ekuilibruara që auditori duhet të ndjek. Këto hapa dhe veprime paraqesin rregullat e hulumtimit që auditori, si kërkues i dëshmimeve të auditimit, implementon për të arritur një rezultat të caktuar.

3.0.2 Standardet e terrenit krijojnë kornizën për kryerjen dhe administrimin e aktivitetit të auditimit. Ato janë të ndërlidhura me standardet e përgjithshme të auditimit, të cilat paraqesin kërkesat themelore për kryerjen e detyrave që mbulohen nga standardet e terrenit. Ato janë po ashtu të ndërlidhura me standardet e raportimit, të cilat mbulojnë aspektin e kumtimit të auditimit, pasi që rezultatet nga ekzekutimi i standardeve të terrenit formojnë burimin kryesor për përmbajtjen e opinionit ose raportit.

3.0.3 Standardet e terrenit të aplikueshme për të gjitha llojet e auditimeve, janë

- (a) Auditori duhet të planifikoi auditimin në mënyrë që ai të sigurohet se është duke u ekzekutuar një auditim i kualitetit të lartë në mënyrë ekonomike, efikase, efektive dhe në kohë (shiko paragrafin 3.1.1).
- (b) Puna e stafit të auditimit në secilin nivel dhe fazë të auditimit duhet të jetë e mbikëqyrur si duhet gjatë procesit të auditimit; dhe puna e dokumentuar duhet të rishikohet nga një anëtar i lartë i stafit të auditimit (shiko paragrafin 3.2.1).

(c) Auditori, gjatë përcaktimit të shtrirjes dhe fushëveprimit të auditimit, duhet të studioi dhe vlerësoi mbështetjen të kontrolli i brendshëm (shiko paragrafin 3.3.1).

(d) Gjatë kryerjes së auditimeve (financiare) të rregullsisë, duhet të kryhet një test i përputhshmërisë (zbatimit) me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Auditori duhet të planifikoi hapat dhe procedurat e auditimit për të siguruar garanci të arsyeshme në lidhje me zbulimin e gabimeve, parregullsisve dhe akteve ilegale që mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë dhe material në shumat e pasqyrave financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullsisë. Auditori po ashtu duhet të jetë i vetëdijshëm mbi mundësinë e akteve ilegale që mund të kenë ndikim të tërthortë dhe material në pasqyrat financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullsisë.

Për të kryer auditime të performancës, duhet të bëhet një vlerësim në lidhje me përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme atëherë kur kjo të jetë e nevojshme për të kënaqur objektivat e auditimit. Auditori duhet të planifikoi auditimin për të ofruar garanci të arsyeshme për zbulimin e veprimeve të paligjshme, që në mënyrë domethënëse mund të ndikojnë në objektivat e auditimit. Auditori po ashtu duhet të jetë vigjilent ndaj situatave ose transaksioneve që mund të jenë sugjeruese të veprimeve të paligjshme që mund të kenë një ndikim të tërthortë në rezultatet e auditimit.

Çfarëdo shenje që një parregullsi, veprim i jashtëligjshëm, mashtrim ose gabim mund të ketë ndodhur, i cili do mund të ketë efekt material mbi auditimin, duhet të shkaktoj që auditori të zgjeroj procedurat për të vërtetuar dyshimet e tilla apo për të flakur ato.

Auditimi i rregullsisë është një aspekt esencial i auditimit qeveritar. Një objektivë e rëndësishme që këtë lloj të auditimit ia cakton ILA-së, është që të siguroj, me çdo kusht dhe me të gjitha mjetet që i janë vënë në dispozicion, që buxheti dhe llogaritë shtetërore janë të plota dhe të vlefshme. Kjo do t'i ofronte Parlamentit dhe shfrytëzuesve tjerë të raportit të auditimit, garancitë në lidhje me madhësinë dhe zhvillimin e obligimeve financiare të shtetit. Për të arritur këtë objektivë, ILA do të ekzaminoi llogaritë dhe pasqyrat financiare të administratës me qëllim të garantimit se të gjitha operacionet janë kryer si duhet, kompletuar, kaluar (miratuar), paguar dhe regjistruar. Procedura e auditimit normalisht rezulton, në mungesë të parregullsisë, në lejimin e "lëshimit" (shiko paragrafin 3.4.1).

- (e) Dëshmi kompetente, relevante dhe të arsyeshme, duhet të sigurohen për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e auditorit për sa i takon organizatës, programit, aktivitetit apo funksionit nën auditim (shiko paragrafin 3.5.1).
- (f) Në auditimet e rregullsisë (financiare) dhe në llojet e tjera të auditimit, atëherë kur është e aplikueshme, auditorët duhet të analizojnë pasqyrat financiare për të përcaktuar nëse standardet e pranueshme të kontabilitetit mbi raportimin dhe shpalosjen financiare, janë duke u zbatuar. Analiza të pasqyrave financiare duhet të kryhet deri në atë shkallë sa të sigurohet baza e arsyeshmërisë për të dhënë një opinion mbi pasqyrat financiare (shiko paragrafin 3.6.1).

3.1 Planifikimi

3.1.1 Standardet e terrenit përfshijnë

Auditori duhet të planifikoi auditimin në mënyrë që ai të sigurohet se është duke u ekzekutuar një auditim i kualitetit të lartë në mënyrë ekonomike, efikase, efektive dhe në kohë (shiko paragrafin 3.0.3a).

Paragrafët vijues shpjegojnë planifikimin si një standard të auditimit.

3.1.2 ILA duhet t'i jap përparësi çfarëdo detyre audituese që, sipas ligjit, duhet të ndërmerret dhe të vlerësojë prioritetet për fushat opcionale në kuadër të mandatit të ILA-së.

3.1.3 Gjatë planifikimit të auditimit, auditori duhet:

- (a) të përcaktoj aspektet e rëndësishme të ambientit në të cilin operon entiteti që auditohet;
- (b) të zhvilloj një të kuptuar mbi marrëdhëniet e përgjegjshmërisë;
- (c) të marrë parasysh formën, përmbajtjen dhe përdoruesit e opinioneve audituese, konkluzioneve apo raporteve;
- (d) të qartësoj objektivat e auditimit dhe testet e nevojshme për t'i arritur ato:

- (e) të identifikoj sistemet dhe kontrollat kyçe të menaxhmentit dhe të kryej një vlerësim preliminar për të identifikuar si anët e forta ashtu edhe dobësitë;
- (f) të përcaktoj materialitetin e çështjeve që do të shqyrtohen;
- (g) të rishikoj auditimin e brendshëm të entitetit që auditohet dhe programin e tij të punës;
- (h) të vlerësoj nivelin e mbështetjes që mund të vendoset në auditorët tjerë, për shembull, auditorët e brendshëm;
- (i) përcaktoj qasjen më efikase dhe efektive audituese;
- (j) bëj rishikimin për të përcaktuar nëse veprime të duhura janë ndërmarrë në lidhje me të gjeturat dhe rekomandimet audituese të raportuara më parë; dhe
- (k) siguroj dokumentacionin e duhur të planit të auditimit dhe punën në terren të propozuar.

3.1.4 Hapat vijues të planifikimit zakonisht përfshihen gjatë auditimit:

- (a) mbledhja e informatave në lidhje me entitetin që auditohet dhe organizimin e tij, për të vlerësuar rrezikun dhe përcaktuar materialitetin;
- (b) përcaktimi i objektivës dhe fushëveprimit të auditimit;
- (c) kryerja e analizave preliminare/fillestare për të përcaktuar qasjen që do të përdoret, llojin dhe gjerësinë e kërkimit të dhënave që do të aplikohet më vonë;
- (d) nxjerrja në pah e problemeve të veçanta të parapara kur të planifikohet auditimi;
- (e) përgatitja e buxhetit dhe e orarit për auditim;
- (f) identifikimi i kërkesave të stafit dhe ekipit të auditimit; dhe
- (g) familjarizimi i entitetit që auditohet me fushëveprimin, objektivat dhe kriterin e vlerësimit të auditimit dhe diskutimi me ata nëse është e nevojshme.

ILA mund që gjatë auditimit të rishikoi planin, kur kjo të shihet e nevojshme.

3.2 Mbikëqyrja dhe Rishikimi

3.2.1 Standardet e Terrenit përfshijnë

Puna e stafit auditues në secilin nivel dhe faze të auditimit, duhet të mbikëqyret në mënyrën e duhur gjatë auditimit dhe se puna e dokumentuar duhet të rishikohet nga një anëtar i lartë i stafit të auditimit (shiko paragrafin 3.0.3b).

Paragrafët vijues shtjellojnë mbikëqyrjen dhe rishikimin si një standard të auditimit.

3.2.2 Mbikëqyrja është esenciale për të siguruar përmbushjen e objektivave të auditimit dhe ruajtjen e kualitetit të punës audituese. Për atë, mbikëqyrja dhe kontrolli i duhur janë të domosdoshme në të gjitha rastet, pavarësisht nga aftësitë e auditorëve individual.

3.2.3 Mbikëqyrja duhet të bëhet si për sa i takon përmbajtjes ashtu edhe metodës së auditimit. Ajo përfshinë sigurimin që:

- (a) anëtarët e ekipit të auditimit e kuptojnë qartë dhe konsistente planin e auditimit;
- (b) auditimi kryhet në përputhje me standardet e auditimit dhe praktikat e ILA-së;
- (c) plani i auditimit dhe hapat veprues të qartësuar në atë plan duhet të zbatohen përveç nëse ndryshimi autorizohet;
- (d) letrat e punës përmbajnë dëshmi që në mënyrën e duhur mbështesin të gjitha konkluzionet, rekomandimet dhe opinionet;
- (e) auditori përmbush objektivat e cekura të auditimit; dhe
- (f) raporti i auditimit përfshinë konkluzionet, rekomandimet dhe opinionet e auditimit, siç është e kërkuar.

3.2.4 E tërë puna audituese duhet të rishikohet nga një anëtar i lartë i stafit auditues para se të finalizohen opinionet ose raportet e auditimit. Kjo duhet të kryhet

si cilado pjesë e progresit të auditimit. Rishikimi i sjell detyrës audituese më shumë se një nivel të përvojës dhe gjykimit dhe duhet të siguroi që:

- (a) të gjitha vlerësimet dhe konkluzionet janë mire të bazuara dhe mbështeten në dëshmi audituese kompetente, relevante dhe të arsyeshme, që përbëjnë themelet e opinionit apo raportit final të auditimit;
- (b) të gjithë gabimet, të metat dhe çështjet e pazakonta janë identifikuar dhe dokumentuar në mënyrën e duhur dhe ose janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme ose janë sjell në vëmendjen e zyrtar-it-ve më të lartë të ILA-së; dhe
- (c) ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme për kryerjen e auditimeve të ardhshme, janë identifikuar, regjistruar dhe marrë parasysh në planet e mëvonshme të auditimit dhe në aktivitetet e zhvillimit të stafit.

3.2.5 Ky standard funksionon ndryshe në ILA-të e organizuara në formë kolegji. Në një strukturë të tillë, vendimet, përveç atyre të llojit rutinor, merren mbi bazë kolegjiale, në nivel që i përshtatet rëndësisë së çështjes.

Një entitet i tillë, si tërësi, vendos mbi fushëveprimin e ekzaminimit, për testet që duhet të ndërmerren dhe metodat që duhet të përdoren.

3.3 Studimi dhe Vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm

3.3.1 Standardet e Terrenit përfshijnë

Auditori, në përcaktimin e shkallës dhe fushëveprimit të auditimit, duhet të studioj dhe vlerësoj besueshmërinë e kontrollit të brendshëm (shiko paragrafin 3.0.3c).

Paragrafët vijues shpjegojnë kontrollin e brendshëm si një standard të auditimit.

3.3.2 Studimi dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm duhet të kryhet bazuar në llojin e auditimit të ndërmarrë. Në rast të auditimit (financiar) të rregullsisë, studimi dhe vlerësimi bëhen kryesisht në kontrollat që i ndihmojnë ruajtjes së pasurisë dhe resurseve dhe sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e të dhënave kontabël. Në rast të auditimit të rregullsisë (zbatueshmërisë), studimi dhe vlerësimi bëhen kryesisht në kontrollat që ndihmojnë menaxhmentin që të veprimi në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve. Në rast të auditimit të performancës, ato bëhen në kontrollat që ndihmojnë në ekzekutimin e afarizmit të entitetit që auditohet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive, duke siguruar zbatim të politikave të menaxhmentit dhe nxjerrjen në kohë të informatave të besueshme financiare dhe të menaxhmentit.

3.3.3 Shtrirja e studimit dhe vlerësimit të kontrollit të brendshëm varet nga objektivat e auditimit dhe në shkallën e mbështetjes së synuar.

3.3.4 Aty ku sistemet e kontabilitetit apo sistemet e tjera informative janë të kompjuterizuara, auditori duhet të përcaktojë nëse kontrollat e brendshme janë duke funksionuar si duhet për të siguruar integritetin, besueshmërinë dhe tërësinë e të dhënave.

3.4 Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve të Aplikueshme

3.4.1 Standardet e Terrenit përfshijnë:

Gjatë kryerjes së auditimeve (financiare) të rregullsisë, duhet të bëhet një test i përputhshmërisë (zbatimit) me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Auditori duhet të hartoj hapat dhe procedurat e auditimit për të ofruar garanci të arsyeshme për gjetjen e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të jashtëligjshme, që mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë dhe material në shumat e prezantuara në pasqyrat financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullsisë. Auditori po ashtu duhet të jetë i vetëdijshëm për mundësinë e veprimeve të jashtëligjshme që mund të kenë një ndikim të tërthortë me material në pasqyrat financiare ose në rezultatet e auditimeve të rregullsisë.

Në kryerjen e auditimeve të performances, duhet të bëhet një vlerësim në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme atëherë kur ajo të është e nevojshme për të plotësuar objektivat e auditimit. Auditori duhet të hartoj auditimin për të ofruar garanci të arsyeshme për gjetjen e veprimeve të jashtëligjshme që në mënyrë domethënëse mund të ndikonin objektivat e auditimit. Auditori duhet po ashtu të jetë vigjilent ndaj situatave ose transaksioneve që do mund të ishin sugjeruese të veprimeve të jashtëligjshme që do mund të kenë një ndikim të tërthortë në rezultatet e auditimit.

Auditimi i rregullsisë është një aspekt esencial i auditimit qeveritar. Një objektivë e rëndësishme që këtë lloj të auditimit ia cakton ILA-së, është që të siguroj, me çdo kusht dhe me të gjitha mjetet që i janë vënë në dispozicion, që buxheti dhe llogaritë shtetërore janë të plota dhe të vlefshme. Kjo do t'i ofronte Parlamentit dhe shfrytëzuesve tjerë të raportit të auditimit, garancitë në lidhje me madhësinë dhe zhvillimin e obligimeve financiare të shtetit. Për të arritur këtë objektivë, ILA do të ekzaminoi llogaritë dhe pasqyrat financiare të administratës me qëllim të garantimit se të gjitha operacionet janë kryer si duhet, kompletuar, miratuar, paguar dhe regjistruar. Procedura e auditimit, në mungesë të parregullsisë, normalisht rezulton me lejimin e "lëshimit" (shiko paragrafin 3.0.3d).

Paragrafet vijuese shpjegojnë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve si një standard të auditimit.

3.4.2 Rishikimi i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve është veçanërisht e rëndësishme kur të bëhet auditimi i programeve qeveritare, sepse marrësit e vendimit duhet të dinë nëse ligjet dhe rregulloret janë duke u zbatuar, nëse ato janë duke dhënë rezultatet e dëshiruara dhe nëse jo çfarë rishikimesh janë të nevojshme. Gjithashtu, organizatat, programet, shërbimet, aktivitetet dhe funksionet qeveritare krijohen përmes ligjeve dhe janë subjekti I rregulloreve dhe rregullave më të detajizuara.

3.4.3 Ata që planifikojnë auditimin duhet të jenë të mirinformuar mbi kërkesat ligjore që duhet të zbatohen nga entiteti që është duke u audituar. Për shkak se numri i ligjeve dhe rregulloreve që mund të kenë të bëjnë me një auditim të caktuar është shpesh i lartë, auditorët duhet të përdorin gjykimin profesional gjatë përcaktimit të atyre ligjeve dhe rregulloreve që do mund të kishin ndikim domethënës në objektivat e auditimit.

3.4.4 Auditori duhet po ashtu të jetë vigjilent ndaj situatave apo transaksioneve që do mund të jenë sugjeruese të veprimeve të jashtëligjshme që mund në mënyrë të tërthortë të ndikojnë në rezultatet e auditimit. Atëherë kur hapat dhe procedurat audituese sugjerojnë se veprimet e jashtëligjshme kanë ose mund të kenë ndodhur, auditori duhet të përcaktoj shkallën deri ku këto veprime ndikojnë rezultatet e auditimit.

3.4.5 Për të kryer auditimet në përputhje me këtë standard, auditorët duhet të zgjedhin dhe kryejnë hapat dhe procedurat e auditimit që, sipas gjykitimit të tyre profesional, janë të përshtatshme për rrethanat. Këta hapa dhe procedura të auditimit duhet të jenë të dizajnuara për të mbledhur dëshmi të mjaftueshme, kompetente dhe relevante që do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për gjykimet dhe konkluzionet e tyre.

3.4.6 Në përgjithësi, menaxhmenti është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm për të siguruar zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve. Në hartimin e hapave dhe procedurave për të testuar ose vlerësuar zbatimin, auditorët duhet të vlerësojnë kontrollat e brendshme të entitetit dhe të përcaktojnë rrezikun që struktura e kontrollit mund të mos e parandaloj apo të zbuloj mos-zbatimin.

3.4.7 Pa ndikuar pavarësinë e ILA-së, auditorët duhet të ushtrojnë kujdes të duhur profesional dhe maturi në zgjerimin e hapave dhe procedurave përkatëse të auditimit për veprimet e jashtëligjshme, ashtu që të mos ndërhyjnë në hetimet apo procedimet ligjore të mundshme në të ardhmen. Kujdesi i duhur do të përfshinte konsultimin e këshilltarit të duhur ligjor dhe me organizatat që merren me zbatimin e ligjeve të aplikueshme për të përcaktuar hapat dhe procedurat e auditimit që duhet ndjekur.

3.5 Dëshmia e Auditimit

3.5.1 Standardet e terrenit përfshijnë

Dëshmi kompetente, relevante dhe të arsyeshme, duhet të sigurohen për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e auditorit për sa i takon organizatës, programit, aktivitetit apo funksionit nën auditim (shiko paragrafin 3.0.3e).

Paragrafët vijues shpjegojnë dëshminë e auditimit si një standard të auditimit.

3.5.2 Të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit, duhet të mbështeten në dëshmi. Pasi që auditorët rrallë kanë mundësinë të marrin parasysh të gjitha të dhënat në lidhje me entitetin e audituar, është thelbësore që mbledhja e këtyre të dhënave dhe teknikat e mostrimit të zgjidhen me kujdes. Atëherë kur të dhënat nga sistemi i bazuar në kompjuter, janë pjesë e rëndësishme e auditimit dhe besueshmëria e të dhënave është vendimtare për realizimin e objektivave të auditimit, auditorët duhet të sigurojnë veten se të dhënat janë të besueshme dhe relevante

3.5.3 Auditorët duhet të kenë një të kuptuar të duhur të teknikave dhe procedurave siç janë kontrollimi, observimi, hetimi dhe vërtetimi, për të mbledhur dëshmitë e auditimit. ILA duhet të siguroi që teknikat e aplikuara janë të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme të zbulojnë të gjithë gabimet dhe parregullësitë e kuantifikuara si materiale.

3.5.4 Në përzgjedhjen e qasjeve dhe procedurave, konsiderate duhet t'i kushtohet cilësisë së dëshmimeve, p.sh., dëshmitë duhet të jenë kompetente, relevante dhe të arsyeshme.

3.5.5 Auditorët duhet në mënyrën e duhur të dokumentojnë dëshmitë e auditimit në letrat e punës, përfshirë bazën dhe shtrirjen e planifikimit, punën e kryer dhe të gjeturat e auditimit.

3.5.6 Dokumentacioni adekuat është i rëndësishëm për disa arsye. Ai do të:

- (a) vërtetoj dhe mbështes opinionet dhe raportet e auditorit;
- (b) rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e auditimit;

- (c) shërbej si burim i informacionit për përgatitjen e raporteve ose përgjigje ndaj çfarëdo hetimi nga entiteti i audituar ose nga cilado palë tjetër;
- (d) shërbej si dëshmi e zbatimit nga ana e auditorit, të Standardeve të Auditimit;
- (e) lehtësoj planifikimin dhe mbikëqyrjen;
- (f) ndihmoj zhvillimin profesional të auditorit;
- (g) ndihmoj në garantimin që puna e deleguar, të jetë kryer në mënyrë të kënaqshme; dhe
- (h) siguroj dëshmi mbi punën e kryer për referencë në të ardhmen.

3.5.7 Auditori duhet të mbaj në mend që përmbajtja dhe mekanizmat për letrat e punës, pasqyrojnë shkallën e zotësisë, përvojës dhe njohurive që posedon auditori. Letrat e punës duhet të jenë të kompletuara dhe në detaje në mënyrë të mjaftueshme, për të mundësuar një auditor me përvojë, i cili nuk ka ndonjë lidhje të mëparshme me auditimin përkatës, që më pas të konstatoj nga to se çfarë pune është bërë për të mbështetur konkluzionet.

3.6 Analizimi i Pasqyrave Financiare

3.6.1 Standardet e terrenit përfshijnë

Te auditimi i rregullsisë (financiar) dhe te llojet e tjera të auditimeve kur është e aplikueshme, auditorët duhet të analizojnë pasqyrat financiare për të përcaktuar nëse standardet e pranueshme të kontabilitetit në lidhje me raportimin dhe shpalosjen financiare, janë duke u zbatuar. Analizimi i pasqyrave financiare duhet të kryhet deri në atë masë, sa të sigurohet baza e arsyeshmërisë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare (shiko paragrafin 3.0.3f).

Paragrafët vijues shpjegojnë analizimin e pasqyrave financiare si një standard të auditimit.

3.6.2 Analizimi i pasqyrave financiare synon të përcaktoj ekzistimin e lidhjeve të pritura brenda dhe në mes të elementeve të ndryshëm të pasqyrave financiare, duke identifikuar kështu çfarëdo lidhje të papritur dhe çfarëdo tendence të pazakontë.

Rrjedhimisht auditori duhet thellësisht të analizoj pasqyrat financiare dhe të përcaktoj nëse:

- (a) pasqyrat financiare janë të përgatitura në përputhje me standardet e pranueshme të kontabilitetit;
- (b) pasqyrat financiare janë prezantuar duke i dhënë rëndësi të duhur rrethanave të entitetit të audituar;
- (c) shpalosje të mjaftueshme janë prezantuar për elementët e ndryshëm të pasqyrave financiare; dhe
- (d) elementet e ndryshëm të pasqyrave financiare janë vlerësuar, matur dhe prezantuar si duhet.

3.6.3 Metodatat dhe teknikat e analizës financiare varen, në masë të madhe, nga lloji, fushëveprimi dhe objektiva e auditimit dhe në njohuritë dhe gjykimin e auditorit.

3.6.4 Aty ku ILA është e obliguar të raportoj mbi zbatimin e ligjeve buxhetore, auditimi duhet të përfshijë:

- (a) për llogaritë e të hyrave, vërtetimi nëse planifikimet janë të njëjta me buxhetin fillestar dhe nëse auditimi i taksave dhe tatimeve të regjistruara dhe i të hyrave të mbledhura, mund të ekzekutohet përmes krahasimit me pasqyrat financiare vjetore të aktivitetit të audituar;
- (b) për llogaritë e shpenzimeve, verifikimi i kredive për të ndihmuar buxhetet, ligjet e ndryshuara dhe për pjesët e mbetura (buxheti i pashpenzuar), pasqyrat financiare të vitit paraprak.

Kreu IV

Standardet e Raportimit në Auditimin Qeveritar

4.0.1 Nuk është e praktikueshme që të formulohet një rregull për të raportuar për çdo situatë të veçantë. Ky standard është të ndihmoj dhe jo të zëvendësoj gjykimin e matur të auditorit në lidhje me dhënien e një opinionit ose bërjen e një raporti.

4.0.2 Shprehja "raportim" përmban si opinionin e auditorit, ashtu dhe vërejtjet e tjera mbi përmbledhjen e pasqyrave financiare, si rezultat i auditimit (financiar) të rregullsisë dhe raportit të auditorit pas përfundimit të auditimit të performancës.

4.0.3 Opinioni i auditorit mbi përmbledhjen e pasqyrave financiare, është në përgjithësi në format të ngjeshur të standardizuar i cili pasqyron rezultatet e një game të gjerë testesh dhe punëve tjera audituese. Shpesh ekziston një standard që kërkon të raportohet mbi respektimin e ligjeve dhe rregulloreve nga ana e transaksioneve të kryera dhe të raportohet mbi çështjet siç janë sistemet joadekuate të kontrollit, veprimet e jashtëligjshme dhe mashtrimi. Në disa vende, obligimi kushtetues ose statusor mund të kërkojë që ILA të raportoj në veçanti në lidhje me zbatimin e ligjeve buxhetore, harmonizimin e llogaritjeve buxhetore dhe autorizimin e rezultateve të paraqitura në pasqyrat financiare.

4.0.4 Në auditimin e performancës, auditori raporton mbi ekonomizimin dhe efikasitetin me të cilin sigurohen dhe shfrytëzohen resurset dhe efektivitetin përmes të cilit arrihen objektivat. Raporte të tilla mund të variojnë shumë si për nga fushëveprimi ashtu edhe për nga lloji, për shembull; konstatimi nëse resurset janë aplikuar në mënyrë të drejtë, komentimi mbi ndikimin e politikave dhe programeve dhe rekomandimi i ndryshimeve të dizajnuara të rezultojnë në përmirësime.

4.0.5 Me qëllim që të dihen nevojat e arsyeshëm të shfrytëzuesit, raporti i auditorit në të dy auditimet, atë të rregullsisë dhe të performancës, mund të nevojitet të merr në konsideratë periudha apo cikleve raportuese të zgjeruara dhe kërkesa përkatëse dhe të përshtatshme të shpalosjes.

4.0.6 Për lehtësi gjatë referimit në këtë kapitull, fjala "opinion" përdoret për të nënkuptuar konkluzionet e auditorit si rezultat i auditimit (financiar) të rregullsisë dhe mund të përfshijë çështjet e shpjeguara në paragrafin 4.0.3;

fjala "raport" përdoret për të nënkuptuar konkluzionet e auditorit pas auditimit të performancës, siç është shpjeguar në paragrafin 4.0.4.

4.0.7 Standardet e raportimit janë

- (a) Në fund të çdo auditimi, auditori duhet të përgatisë një opinion apo raport të shkruar, varësisht si është e përshtatshme, që paraqet të gjeturat në një formë të duhur; përmbajtja e saj duhet të jetë e lehtë për tu kuptuar dhe e lirë nga paqartësitë ose dykuptimësitë, që të përfshinë vetëm ato informacione të cilat janë të mbështetura me dëshmi audituese të përshtatshme dhe të duhur, dhe të jetë objektive dhe dobiprurëse.
- (b) Varet nga ILA, së cilës edhe i takojnë, për të vendosur përfundimisht mbi veprimet që duhet të ndërmerren për sa i takon praktikave mashtruese ose parregullsitë serioze, të zbuluara nga auditorët.

Për sa i takon auditimeve të rregullsisë, auditori duhet të përgatisë një raport të shkruar, i cili ose mund të jetë pjesë e raportit mbi pasqyrat financiare ose raport në veti, mbi testet e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Raporti duhet të përmbaj një formulim të zotimeve pozitive mbi artikujt e testuar për përputhshmëri dhe zotime negative mbi artikujt e patestuar.

Për sa i takon auditimeve të performancës, raporti duhet të përfshijë të gjitha rastet e rëndësishme të mos-përputhshmërisë që janë të ndërlidhura me objektivat e auditimit.

Paragrafët vijues shpjegojnë raportimin si një standard të auditimit. Paragrafi 4.0.8 i referohet opinionëve dhe raporteve, paragrafët 4.0.9 - 4.0.20 ndërlidhen me opinionet ndërsa paragrafët 4.0.21 - 4.0.26 me raportet.

4.0.8 Forma dhe përmbajtja e të gjithë opinionëve dhe raporteve të auditimit bazohen në parimet e përgjithshme vijuese:

- (a) Titulli. Opinioni apo raporti duhet të paraprihen nga një titull ose emër i përshtatshëm, që i ndihmon lexuesit për të dalluar atë nga formulimet apo informacionet e lëshuara nga të tjerët.
- (b) Nënshkrimi dhe data. Opinioni apo raporti duhet të jetë i nënshkruar si duhet. Përfshirja e datës e informon lexuesin se vëmendje i është kushtuar ndikimit të ngjarjeve apo transaksioneve, për të cilat auditori është vënë në dijeni

deri në atë datë [e cila, në rastin e auditimeve (financiare) të rregullsisë, mund të jenë përtej periudhës së pasqyrave financiare].

- (c) Objektivat dhe fushëveprimi. Opinioni apo raporti duhet të përfshijë referencë ndaj objektivave dhe fushëveprimit të auditimit. Ky informacion krijon qëllimin dhe kufijtë e auditimit.
- (d) Plotësia. Opinionet duhet t'i bashkëngjiten dhe të publikohen me pasqyrat financiare të cilave ato iu referohen, por raportet e performancës mund të publikohen të vetme. Opinionet dhe raportet e auditorëve duhet të prezantohen siç janë përgatitur nga auditori. Gjatë ushtrimit të pavarësisë së saj, ILA duhet të jetë në gjendje të përfshijë çfarëdo që shef si të përshtatshme, por kohë pas kohe mund të mbledh edhe informacione të cilat për hir të interesit kombëtar nuk mund të shpalosen lirshëm. Kjo mund të ndikoj plotësinë e raportit të auditimit. Në një situatë të tillë, auditori mban përgjegjësinë për të konsideruar nevojën për të bërë një raport, ndofta duke i përfshirë të dhënat e fshehta apo të ndjeshme në një raport të veçantë të pabublikuar.
- (e) I adresuari. Opinioni apo raporti duhet të identifikoi ata të cilëve raporti i adresohet, siç kërkohet me kushtet e angazhimit të auditimit dhe rregulloreve apo praktikave lokale. Kjo mund të jetë e panevojshme atëherë ku procedurat formale ekzistojnë në lidhje me dërgimin e tij.
- (f) Identifikimi i subjektit të çështjes. Opinioni apo raporti duhet të identifikoi pasqyrat financiare (gjatë auditimeve (financiare) të rregullsisë ose të fushës (gjatë auditimeve të performancës) të cilave iu referohet. Kjo përfshinë informata siç janë emri i entitetit të audituar, data dhe periudha e mbuluar nga pasqyrat financiare dhe subjekti i çështjes që është audituar.
- (g) Baza ligjore. Opinionet dhe raportet e auditimit duhet të paraqesin legjislacionin ose autoritetet tjera që parashikojnë auditimin.
- (h) Përputhshmëria me standarde. Opinionet dhe raportet e auditimit duhet të cekin standardet ose praktikat e auditimit të ndjekura gjatë kryerjes së auditimit, duke e pajisur kështu lexuesin me garanci që auditimi është kryer në përputhje me procedurat gjerësisht të pranuar.

- (i) Përpikëria. Opinioni dhe raporti i auditimit duhet të jenë të gatshëm menjëherë, për të qenë më të dobishëm për lexuesit dhe shfrytëzuesit, në veçanti për ata që duhet të ndërmarrin hapat e kërkuar.

4.0.9 Një opinion i auditimit zakonisht jepet në format standard, për sa i përket pasqyrave financiare si tërësi, duke shmangur në këtë mënyrë nevojën për të cekur në gjerësi se çfarë fshihet prapa tij, por duke përcjell, në përputhje me qëllimin e vet, një kuptim të përgjithshëm të domethënies së vet në mesin e lexuesve. Karakteri i këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore për auditim, por përmbajtja e opinionit do duhet të paraqes qartazi nëse është opinion i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe më vonë nëse është i kualifikuar në disa aspekte apo është i kundërt (paragrafi 4.0.14) ose mohim (paragrafi 4.0.15) i opinionit.

4.0.10 Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza dhe politika të pranueshme të kontabilitetit të cilat janë aplikuar në mënyrë konsistente;
- (b) pasqyrat përkojnë me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) gjendja e paraqitur përmes pasqyrave financiare korrespondon me njohuritë që ka auditori për entitetin e audituar; dhe
- (d) ekziston një shpalosje e duhur e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

4.0.11 Theksimi i Çështjes. Në rrethana të caktuara, auditori mund të gjykojë se lexuesi nuk do të sigurojë një të kuptuar të duhur në lidhje me pasqyrat financiare përveç nëse tërhiqet vëmendja për të çështjet e pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, auditori që lëshon një opinion të pakualifikuar, në opinionin e dhënë nuk bën referencë për aspektet e caktuara të pasqyrave financiare në rast se kjo mund të keqinterpretohet si të ishte e kualifikuar. Në mënyrë që të shmangët dhënia e asaj përshtypjeje, referencat që mendohen si "theksim i çështjes" mbahen në një paragraf të veçantë nga opinionin. Megjithatë, auditori nuk duhet të shfrytëzojë theksimin e çështjes dhe të korrigjojë mungesën e shpalosjes së duhur në pasqyrat financiare, dhe as të mos shfrytëzojë atë si një alternativë ndaj, apo zëvendësim për, të kualifikuar opinionin.

4.0.12 Auditori mund të mos jetë në gjendje të jap një opinion të pakualifikuar atëherë kur ekziston ndonjëra nga rrethanat vijuese dhe sipas gjykimit të auditorit, ndikimi i tyre është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

- (a) kur ka pasur kufizim në fushëveprimin e auditimit;
- (b) kur auditori mendon se pasqyrat janë të mangëta ose çorientuese, apo se ekziston një shmangie e pa-arsyetueshme nga standardet e pranuar të kontabilitetit; ose
- (c) ka paqartësi që ndikon në pasqyrat financiare.

4.0.13 Opinioni i Kualifikuar. Atëherë kur auditori nuk pajtohet, ose është i pasigurt në lidhje me një apo më shumë artikuj të caktuar të pasqyrave financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për kuptimin e pasqyrave, duhet të lëshohet një opinion i kualifikuar. Terminologjia e përdorur në shprehjen e opinionit zakonisht sugjeron për një rezultat të kënaqshëm në lidhje me subjektin e auditimit, për një formulim të qartë dhe të ngjeshur të çështjeve të mosbarazimit apo mospërputhjes, që i hapin rrugë opinionit të kualifikuar. Do t'i ndihmonte shfrytëzuesve të pasqyrave nëse ndikimi financiar i paqartësisë apo mospërputhjes të jetë i matur nga auditori, edhe pse kjo nuk është çdo herë e praktikueshme apo e rëndësishme.

4.0.14 Opinioni i Kundërt. Atëherë kur auditori është në pamundësi të formoj një opinion mbi pasqyrat financiare të marra si tërësi, për shkak të mospërputhjeve që janë aq thelbësore sa të kundërshtojnë pozitën e prezantuar deri në atë shkallë sa që opinionin i cili është i kualifikuar në disa aspekte, nuk do të ishte adekuat, dhe në këto raste lëshohet një opinion i kundërt. Terminologjia e përdorur në dhënien e një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mospërputhjes. Prapë, do të ishte e dobishme nëse ndikimi financiar në pasqyrat financiare të matej, aty ku është e rëndësishme dhe e praktikueshme.

4.0.15 Mohimi i Opinionit. Atëherë kur auditori është në pamundësi të arrij te një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të marra si tërësi, për shkak të një paqartësie apo kufizimi në fushëveprim e cila është aq thelbësore sa që opinionin që është i kualifikuar në disa aspekte nuk do të ishte adekuat, në këto raste lëshohet mohimi. Terminologjia e përdorur gjatë formulimit të një mohimi të tillë e bën të qartë se nuk mund të lëshohet një opinion, duke paraqitur qartë dhe në mënyrë të ngjeshur të gjitha çështjet e mospërputhjes.

4.0.16 Është e zakonshme që ILA-t të nxjerrin një raport të hollësishëm duke e zgjeruar opinionin për sa i takon rrethanave që kanë shkaktuar pamundësinë e dhënies së një opinionin të pakualifikuar.

4.0.17 Gjithashtu, auditimet e rregullsisë shpesh kërkojnë që raportet të nxirren për aty ku ekzistojnë të meta në sistemet e kontrollit financiar apo kontabilitetit (pasi që janë të veçuara nga aspektet e auditimit të performancës). Kjo mund të ndodhë jo vetëm aty ku të metat ndikojnë procedurat e vet entitetit të audituar por edhe aty ku ato kanë të bëjnë me kontrollin e saj mbi aktivitetet e të tjerëve. Auditori po ashtu duhet të raportoj mbi parregullsitë e rëndësishme në lidhje me paqëndrueshmërinë në aplikimin e rregulloreve apo në lidhje me mashtrimin dhe praktikën e korruptuara, pavarësisht nëse ato janë të nuhatura apo potenciale,

4.0.18 ILA-t që kanë statut juridik kanë kompetencën për të ndërmarrë masa në lidhje me parregullsitë e caktuara të zbuluara në pasqyrat financiare. Ato mund të jenë të autorizuar të harmonizojnë llogaritë e përgatitura nga kontabilistët dhe t'i vendosin atyre gjoba dhe në rrethana të caktuara mund të shkaktojnë suspendimin apo edhe largimin e tyre nga puna.

4.0.19 Për sa i takon raportimit në lidhje me parregullsitë apo rastet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret, auditorët duhet të jenë të kujdesshëm të vendosin të gjeturat e tyre nga këndvështrimi i duhur. Shkalla e mospërputhshmërisë mund t'i referohet numrit të rasteve të ekzaminuara apo mund të matet edhe në vlerë.

4.0.20 Raportet në lidhje me parregullsitë mund të përgatiten pavarësisht nga kualifikimi i opinionit të auditorit. Nga natyra e tyre, ato kanë një tendencë të përmbajnë kritikizëm domethënës, por me qëllim që të jenë të dobishme ato po ashtu duhet të adresojnë veprimet korrigjuese të ardhshme duke përfshirë deklaratimet e bëra nga entiteti i audituar ose nga auditori, përfshirë konkluzionet dhe rekomandimet.

4.0.21 Ndryshe nga auditimi i rregullsisë, i cili është subjekt i kërkesave dhe pritjeve mjaft të hollësishme, auditimi i performancës është i shumëllojshëm për nga natyra dhe është më i hapur ndaj gjykimit dhe interpretimit; mbulimi po ashtu është më shumë selektiv dhe mund të kryhet gjatë një cikli prej disa vitesh, e më pak brenda një periudhe financiare; dhe zakonisht nuk i referohet në veçanti pasqyrave të caktuara financiare apo pasqyrave tjera. Rrjedhimisht, raportet e auditimit të performancës ndryshojnë dhe përmbajnë më shumë diskutime dhe argumente logjike.

4.0.22 Raporti i auditimit të performancës duhet të paraqes në mënyrë të qartë objektivat dhe fushëveprimin e auditimit. Raportet mund të përfshijnë kritika (për shembull atëherë kur në interes të publikut ose mbi bazë të përgjegjshmërisë publike, çështjet e shpërdorimeve serioze, shpenzimeve të tepëruara apo jo-efikasitetit, vihen në vëmendje) ose mund të mos përmbajnë kritika serioze por të paraqesin informata të pavarura, këshilla ose siguri në lidhje me atë nëse dhe deri në çfarë mase ekonomizimi, efikasiteti dhe efektiviteti janë duke u përmbushur apo janë përmbushur.

4.0.23 Nga auditori zakonisht nuk pritet të siguroi një opinion gjithëpërfshirës në lidhje me përmbushjen e ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit nga ana e entitetit të audituar, në të njëjtën mënyrë si në lidhje me opinionin mbi pasqyrat financiare. Aty ku lloji i auditimit e lejon këtë të bëhet, për sa i përket fushave të caktuara të aktiviteteve të entitetit, auditori duhet të siguroj një raport i cili paraqet rrethanat dhe më parë arrin në një konkluzion të caktuar se te një deklaratë e standardizuar. Aty ku auditimi është i kufizuar për vlerësim në lidhje me atë nëse ekzistojnë kontrole të mjaftueshme për të siguruar arritjen e ekonomizimit, efikasitetit apo efektivitetit, auditori mund të nxjerr një opinion më të përgjithësuar.

4.0.24 Auditorët duhet të dinë se gjykimet e tyre aplikohen në vepra si rezultat i vendimeve të kaluara të menaxhmentit. Për atë, rrjedhimisht, duhet të ushtrohet kujdes gjatë marrjes së vendimeve të tilla dhe raporti duhet të tregoj llojin dhe madhësinë e informacionit të disponueshëm në mënyrë të arsyeshme (ose i cili duhet të ketë qenë në disponim) për entitetin e audituar në kohën e marrjes së vendimeve. Duke i cekur qartë fushëveprimin, objektivat dhe të gjeturat e auditimit, raporti i demonstroi lexuesit që auditori është duke u treguar i paanshëm. Paanësia po ashtu nënkupton prezantimin e të metave ose të gjeturave vendimtare në mënyrë të tillë sa të nxis korrigjimin dhe përmirësimin e sistemeve dhe të ofroj drejtim për entitetin e audituar. Prandaj, faktet në përgjithësi dakordohen me entitetin e audituar me qëllim që të sigurohet se ato janë të plota, të sakta dhe të prezantuara drejtë në raportin e auditimit. Po ashtu mund të ekzistoj nevojat të përfshihen përgjigjet e entitetit të audituar për çështjet e ngritura, fjalë për fjalë ose në përmbledhje, veçanërisht aty ku ILA paraqet pikëpamjet apo rekomandimet e veta.

4.0.25 Raportet e performancës nuk duhet të përqendrohen vetëm në të kritikuarit e të kaluarës por duhet të jenë të dobishme. Konkluzionet dhe rekomandimet e auditorit janë një aspekt i rëndësishëm i auditimit dhe aty ku është e përshtatshme, shkruhen si udhërrëfyes për veprim. Në përgjithësi, këto rekomandime më shumë sugjerojnë se çfarë përmirësimesh nevojiten se sa si të arrihen ato, edhe pse ndonjëherë dalin rrethana të cilat e arsyetojnë një rekomandim të caktuar, për shembull, të përmirësohet një defekt në ligj në mënyrë që të arrihet një përmirësim administrativ.

4.0.26 Gjatë formulimit dhe përcjelljes së rekomandimeve, auditori duhet të ruan objektivitetin dhe pavarësinë dhe kështu më parë të përqendrohet në atë nëse të metat e identifikuara janë përmirësuar se sa nëse janë pranuar rekomandimet e caktuara.

4.0.27 Gjatë formulimit të opinionit apo të raportit të auditimit, auditori duhet të ketë parasysh materialitetin e çështjes në aspektin e pasqyrave financiare [auditimi (financiar) i rregullsisë] apo llojin e entitetit apo aktivitetit të audituar (auditimi i performancës).

4.0.28 Për sa i takon auditimeve (financiare) të rregullsisë, nëse auditori konkludon se, duke e gjykuar sipas kriterit më të përshtatshëm për rrethanat, çështja nuk e ndikon materialisht pamjen e paraqitur nga pasqyrat financiare, opinionin nuk duhet të jetë i kualifikuar. Atëherë kur auditori vendos se një çështje është materiale, opinionin duhet të jetë i kualifikuar, duke pasur të përcaktuar llojin e kualifikimit (paragrafët 4.0.12 - 4.0.15).

4.0.29 Gjatë rasteve të auditimeve të performancës, ky gjykim do të jetë më subjektiv pasi që raporti nuk i referohet aq drejtpërdrejtë pasqyrave financiare ose pasqyrave tjera. Rrjedhimisht, auditori mund të gjejë se materialiteti sipas llojit apo aspektit (kontekstit) është një faktor më i rëndësishëm se sa materialiteti sipas shumës.

Lista e fjalëve

Sistemi i Kontrollit të Kontabilitetit

Një varg veprimesh që konsiderohen të jenë pjesë e sistemit të plotë të kontrollit të brendshëm që merren me realizimin e qëllimeve të kontabilitetit të entitetit. Ky përfshinë përputhshmërinë me politikat dhe procedurat kontabël dhe financiare, që ruajnë resurset e entitetit dhe përgatisin raporte të besueshme financiare.

Sistemi i Kontrollit Administrativ

Një varg veprimesh, që duke qenë pjesë përbërëse e sistemit të kontrollit të brendshëm përgjegjës për procedurat administrative të nevojitura për të marrë vendime menaxheriale, realizojnë efikasitetin më të lartë të mundshëm ekonomik dhe administrativ dhe sigurojnë implementimin e politikave administrative, qofshin ato të ndërlidhura me çështjet financiare apo të tjera.

Entiteti i Audituar/Entiteti që auditohet

Organizata, programi, aktiviteti ose funksioni subjekt i auditimit të kryer nga ILA.

Dëshmia e Auditimit

Të dhënat që formojnë bazën e cila mbështet opinionin, konkluzionet apo raportet e ILA-së.

Kompetente: informatat që në sasi janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të realizuar rezultatet e auditimit; dhe në cilësi janë të paanshme aq sa të frymëzojnë mirëbesimin dhe mbështetje.

Relevante: informatat që janë të ndërlidhura me objektivat e auditimit.

Të arsyeshme: informatat që janë ekonomike ashtu që kostoja e mbledhjes së tyre është e barabartë me rezultatin të cilin auditori ose ILA synon të arrijë.

Mandati i Auditimit

Përgjegjësitë audituese, kompetencat, liria e vendosjes dhe detyrat e akorduara ILA-së, sipas kushtetutës apo ndonjë autoriteti tjetër ligjor të ndonjë shteti.

Objektiva e Auditimit

Një deklaratë e përpiktë mbi atë se çfarë synon të përmbush auditimi dhe/ose pyetjes së cilës auditimi do t'i përgjigjet. Kjo mund të përfshijë çështje, financiare, të rregullsisë apo të performancës.

Procedurat e Auditimit

Testimet, udhëzimet dhe detajet e përfshira në programin e auditimit, që duhet të kryhen vazhdimisht dhe në mënyrë të arsyeshme.

Fushëveprimi i Auditimit

Korniza apo kufijtë dhe subjektet e auditimit.

Standardet e Auditimit

Standardet e auditimit ofrojnë orientim themelor (minimal) për auditorin që ndihmojnë në përcaktimin e shtrirjes së hapave dhe procedurave audituese që duhet të aplikohen në përmbushje të objektivave të auditimit. Ato janë kriteri ose standardi ndaj të cilit vlerësohet kualiteti i rezultateve të auditimit.

Kushtetues-e

Një çështje e cila lejohet ose autorizohet nga ligji themeltar i një shteti.

Kujdes i Duhur

Elementi i duhur i kujdesit dhe zotësisë që nga një auditor i trajnuar do pritej të aplikohet duke pasur parasysh kompleksitetin e detyrës audituese, përfshirë vëmendje të kujdesshme për planifikimin, mbledhjen dhe vlerësimin e dëshmisë dhe formimin e opinioneve, konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve

Ekonomizimi

Minimizimi i kostos së resurseve të përdorura për një aktivitet, duke ruajtur konsideratën për kualitetin e duhur.

Efektiviteti

Shkalla deri ku objektivat janë arritur dhe raporti në mes të ndikimit të synuar dhe ndikimit aktual të një aktiviteti.

Efikasiteti

Raporti në mes të produktit (outputit) për sa i takon mallrave, shërbimeve apo rezultateve tjera dhe resurseve të përdorura për të nxjerr ato.

Dega Ekzekutive e Qeverisë (Ekzekutivit)

Dega e qeverisë e cila administron ligjin.

Standardet e Terrenit

Korniza për auditorin që në mënyrë sistematike të përmbush objektivin e auditimit, përfshirë planifikimin dhe mbikëqyrjen e auditimit, mbledhjen e dëshmisë kompetente, relevante dhe të arsyeshme dhe një studim dhe vlerësim i duhur i kontrolleve të brendshme.

Sistemet Financiare

Procedurat për përgatitjen, regjistrimin dhe raportimin e informatave të besueshme që ndërlidhen me transaksionet financiare.

Të Gjeturat, Konkluzionet dhe Rekomandimet

Të gjeturat janë dëshmi të caktuara të mbledhura nga auditori për të përmbushur objektivat e auditimit; konkluzionet janë formulime të nxjerra nga auditori nga ato të gjetura; rekomandimet janë hapa të veprimit të sugjeruara nga auditori që ndërlidhen me objektivat e auditimit.

Themelor

Një çështje bëhet themelore (mjaftueshmërisht materiale) më tepër se sa materiale, kur ndikimi i saj në pasqyrat financiare është aq i madh sa që ato të përshkruhen në tërësi si çorientuese.

Standardet e Përgjithshme

Kualifikimet dhe kompetenca, pavarësia e domosdoshme dhe objektiviteti si dhe ushtrimi i kujdesit të duhur, të cilat kërkohen nga auditori për të kryer detyrat e ndërlidhura me standardet e terrenin dhe të raportimit në mënyrë kompetente, efikase dhe efektive.

Pavarësia

Liria e ILA-së në çështjet audituese, për të vepruar në harmoni me mandatin e saj auditues pa direksione apo ndërhyrje të çfarëdo lloji nga jashtë.

Auditimi i Brendshëm

Mjetet funksionale përmes të cilave menaxherët e një entiteti krijojnë siguri nga burimet e brendshme se proceset për të cilin ata janë përgjegjës, janë duke funksionuar në atë mënyrë që do të minimizojnë mundësinë e shfaqjes së mashtrimit, gabimit apo e praktikave joefikase dhe joekonomike. Ai ka shumë nga karakteristikat e auditit të jashtëm por mund të kryej në mënyrë të duhur udhëzimet e nivelit menaxherial të cilit edhe i raporton.

Kontrolli i Brendshëm

I tërë sistemi i kontrollave financiare dhe të tjera, përfshirë strukturën organizative, metodat, procedurat dhe auditin e brendshëm, të vendosura nga menaxhmenti në kuadër të qëllimeve të saj operative, për të ndihmuar në udhëheqjen e afarizimit të entitetit të audituar në mënyrë të rregullt ekonomike, efikase dhe efektive; duke siguruar përputhshmëri me politikat e menaxhmentit; ruajtjen e pasurisë dhe resurseve; sigurimin e përpikërisë dhe plotësisë së të dhënave kontabël; dhe nxjerrjen e informatave financiare dhe menaxhuese të besueshme dhe në kohë.

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI, shqip ONILA)

Një institucion ndërkombëtar dhe i pavarur synimi i të cilit është të promovoj shkëmbimin e ideve dhe përvojës në mes të Auditit të Lartë në fushën e kontrollit financiar publik.

Legjislativi

Organi shtetëror i hartimit të ligjeve, për shembull Parlamenti.

Auditimi i Menaxhmentit

Analiza e shpenzimeve publike nga aspekti i parimeve të përgjithshme të menaxhmentit të duhur.

Materialiteti dhe Rëndësia (Materiale)

Në terma të përgjithshëm, një çështje mund të gjykohet materiale nëse njohja e saj do të ketë të ngjarë të influencoj përdoruesin e pasqyrave financiare apo raportin e auditimit të performancës. Materialiteti shpesh trajtohet në aspekt të vlerës por se natyra e vetvetishme e karakteristikave të një artikulli apo grupi të artikujve mund po ashtu të bëjë një çështje materiale –për shembull, aty ku ligji apo ndonjë rregullore tjetër kërkon nga ajo të shpaloset ndaras pavarësisht nga shuma e përfshirë. Përveç materialitetit sipas vlerës dhe llojit, një çështje mund të jetë materiale për shkak të kontekstit në të cilën paraqitet. Për shembull, marrja parasysh e një artikulli për sa i takon pamjes së përgjithshme të prezantuar sipas llogarive; totali i të cilës formon një pjesë; kushtet e ndërlidhura; shuma përkatëse nga vitet e kaluara. Dëshmia e auditimit luan një rol të rëndësishëm në vendimin e auditorit në lidhje me përzgjedhjen e çështjeve dhe fushave për auditim dhe natyrës, momentit dhe shtrirjes së testeve dhe procedurave të auditimit.

Opinion

Konkluzionet e shkruara të auditorit në lidhje me grupin e pasqyrave financiare, si rezultat i auditimit financiar apo të rregullsisë.

Auditimi i Performancës

Auditimi i ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit me të cilat entiteti i audituar i shfrytëzon resurset e saj gjatë ekzekutimit të përgjegjësive të veta.

Planifikimi

Përcaktimi i objektivave, instalimi i politikave dhe përcaktimi i llojit, fushëveprimit, shtrirjes dhe kohës së procedurave dhe testeve të nevojitura për të arritur objektivat.

Parimet

Supozimet bazë, premiset konsistente, parimet dhe kërkesat e logjikshme të cilat përfaqësojnë kornizën e përgjithshme për zhvillimin e standardeve të auditimit.

Përgjegjshmëria Publike

Obligimet e personave apo entiteteve, përfshirë ndërmarrjet publike dhe korporatat, të cilave iu janë besuar resurset publike për të qenë llogaridhënës për përgjegjësitë fiskale, menaxheriale dhe programore që u janë akorduar atyre dhe për të raportuar tek ata të cilët i kanë akorduar këto përgjegjësi tek ata.

Auditimi i Rregullsisë

Verifikimi i përgjegjshmërisë financiare të entiteteve përgjegjëse, përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare dhe dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare; verifikimin e përgjegjshmërisë financiare të administratës qeveritare në tërësi; auditimin e sistemeve dhe transaksioneve financiare përfshirë një vlerësim në lidhje me zbatimin e statuteve dhe rregulloreve të aplikueshme; auditimin e kontrollit të brendshëm dhe funksioneve të auditit të brendshëm; auditimi i ndershmërisë dhe adekuatshmërisë së vendimeve administrative të marra nga entiteti i audituar; dhe raportimi i cilësdo çështje tjetër që del nga auditimi ose ka të bëjë me të dhe që ILA e konsideron se duhet të shpaloset.

Raporti

Opinionit dhe vërejtjet e tjera të shkruara të auditorit për sa i takon grumbullit të pasqyrave financiare, si rezultat i auditimit financiar ose të rregullsisë apo të të gjeturave të auditorit në lidhje me kryerjen e auditimit të performancës.

Standardet e Raportimit

Korniza për auditorin për sa i takon raportimit të rezultateve të auditimit, përfshirë drejtim në lidhje me formën dhe përmbajtjen e raportit të auditorit.

Mbikëqyrja

Një kërkesë esenciale gjatë auditimit e cila përfshinë udhëheqje, drejtim dhe kontroll të duhur gjatë të gjitha fazave për të siguruar një lidhje kompetente, efektive në mes të aktiviteteve, procedurave dhe testeve që janë duke u kryer dhe qëllimeve që synohen të arrihen.

Institucioni i Lartë i Auditimit (ILA)

Organ publik i Shtetit i cili, pavarësisht se si është i emëruar, i strukturuar apo i organizuar, ushtron me ndershmërinë e ligjit, funksionin më të lartë publik të auditimit të Shtetit.